



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PUSTEC**

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI AUDITIMIN FINANCIAR**

**NË**

**BASHKINË PUSTEC**

**Tiranë, Shkurt 2024**

## **SHKURTIME**

|                |  |
|----------------|--|
| <b>AAJM</b>    | Aktive Afatgjata Jo Materiale  |
| <b>AAM</b>     | Aktive Afatgjata Materiale   |
| <b>ALUIZNI</b> | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale |
| <b>AK</b>      | Autoritet Kontraktor   |
| <b>AKM</b>     | Agjencia Kombëtare e Mjedisit  |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara  |
| <b>ASHK</b>    | Agjencia Shtetërore e Kadastrës  |
| <b>AZHT</b>    | Agjencia e Zhvillimit të Territorit  |
| <b>BOE</b>     | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë  |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve   |
| <b>GMS</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik  |
| <b>IFAC</b>    | Federata Ndërkombëtaree Kontabilistëve   |
| <b>INTOSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit                       |
| <b>IPSAS</b>   | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik                       |
| <b>ISA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit  |
| <b>ISSAI</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit                      |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit  |
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit  |
| <b>KPP</b>     | Komisioni i Prokurimit Publik  |
| <b>KVO</b>     | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave   |
| <b>LPP</b>     | Ligji i Prokurimit Publik  |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli  |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues   |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative   |
| <b>NJP</b>     | Njësia e Prokurimit  |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues  |
| <b>OE</b>      | Operator Ekonomik  |
| <b>OSHEE</b>   | Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike                                      |
| <b>PF</b>      | Pasqyrat Financiare  |
| <b>PMNZSH</b>  | Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim                                       |
| <b>PPV</b>     | Plani i Përgjithshëm Vendor  |
| <b>QKB</b>     | Qendra Kombëtare e Biznesit  |
| <b>SHA</b>     | Shoqëri Anonime  |
| <b>SHPK</b>    | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar   |
| <b>SKK</b>     | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit   |
| <b>UMF</b>     | Udhëzim i Ministrisë së Financave  |
| <b>UP</b>      | Urdhër Prokurimi   |
| <b>USH</b>     | Urdhër Shpenzimi   |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak  |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave   |

| .                |              | <b>PËRMBAJTJA</b>  | <b>Faqe</b>  |
|------------------|--------------|--|--------------|
| <b>SHKURTIME</b> |              |  | <b>2-8</b>   |
| <b>I</b>         |              | <b>PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>  | <b>4-8</b>   |
|                  | <b>1</b>     | Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit                          | 4-4          |
|                  | <b>2</b>     | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve                        | 4-6          |
|                  | <b>3</b>     | Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit                                 | 6-8          |
| <b>II.</b>       |              | <b>HYRJA</b>   | <b>8-15</b>  |
|                  | <b>1</b>     | Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit                         | 9-9          |
|                  | <b>2</b>     | Identifikimi i çështjes  | 9-9          |
|                  | <b>3</b>     | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese                                  | 9-9          |
|                  | <b>4</b>     | Përgjegjësitë e audituesve   | 9-10         |
|                  | <b>5</b>     | Kriteret e vlerësimit  | 10-12        |
|                  | <b>6</b>     | Standardet e auditimit   | 12-13        |
|                  | <b>7</b>     | Metodat e auditimit  | 13-14        |
|                  | <b>8</b>     | Praktikat e ndjekura   | 14-14        |
|                  | <b>9</b>     | Dokumentimi i auditimit  | 15-15        |
| <b>III.</b>      |              | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>  | <b>16-81</b> |
|                  | <b>1</b>     | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim                   | 16-16        |
|                  | <b>2</b>     | Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit                 | <b>17-81</b> |
|                  | <b>2.1.1</b> | Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm               | 17-23        |
|                  | <b>2.1.2</b> | Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm        | 23-23        |
|                  | <b>2.2.1</b> | Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit                     | 24-33        |
|                  | <b>2.2.2</b> | Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre            | 33-38        |
|                  | <b>2.3</b>   | Vlerësimi Raportimit Financiar   | 38-58        |
|                  | <b>2.3.4</b> | Mbi administrimin e aseteve procedurat e inventarizimit e regjistrimit | 58-60        |
|                  | <b>2.4</b>   | Zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e mëparshme                      | 60-82        |
|                  | <b>2.5</b>   | Të ndryshme, të dala gjatë auditimit                                   | 82-81        |
| <b>IV.</b>       |              | <b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>  | <b>81-88</b> |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim Financiar në Bashkinë Pustec, nga data 04.12.2023 deri në datën 29.12.2023, për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin financiar, në Bashkinë Pustec, është pjesë e Planit Vjetor 2023 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Auditimit.

Auditimi në Bashkinë Pustec u planifikua të zhvillohej nga data 04.12.2023 deri në datën 29.12.2023. Periudha e audituar është 01.01.2022 deri 31.12.2022.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacioneve mbi akt-konstatimet e lëna, hartoi projektraportin e auditimit dhe pasi kaloi shkallët e kontrollit të cilësisë, u dërgua në Bashkinë Pustec me shkresën përcjellëse nr.1028/3, datë 18.01.2024.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| N r | Përmbledhje e Gjetjes  | Referencat me Raportin Përfundimtar | Rëndësia | Rekomandimi   |
|-----|--|-------------------------------------|----------|---|
| 1   | Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 720,898 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit që përbëhet nga shuma e: llog.401-408 “Furnitore e llogari te lidhura me to” në vlerën 1,721,533 lekë, llog.42“Detyrime ndaj personelit” për vlerën 3,328,068 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 136,195 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 1,007,446 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 133,546 lekë, të cilat janë shumën 6,326,788 lekë. Gjithashtu kjo ka sjellë pasaktësi në gjendjen e llogarisë analoge 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në pasqyrën e performancës Formati 2 i PF. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3, nënpika 8. | faqe 38-58                          | e lartë  | Sektori i Financës, Bashkia Pustec në mbyllje të vitit 2023 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara të shtetit/bashkia ndaj të tretëve në llogarinë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”, duke përfshirë detyrimet të gjitha detyrimet për paga, sigurime, tatime ndaj punonjësve dhe detyrimet e lindura ndaj të tretëve për fatura te papaguara në fundvitin ushtrimor të harkut kohor 60 ditë. |

|   |  |            |         |  |
|---|--|------------|---------|--|
| 2 | <p>Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Pra gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv <b>nuk rakordon</b> me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën prej 146,181,288 lekë, që përfaqëson detyrimet e konstatuara të prapambetura ndaj të tretëve për fatura të palikujduara etj. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III, pika 42.</p>  | faqe 38-58 | e lartë | <p>Sektori i Financës, Bashkia Pustec në mbyllje të vitit 2023 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve e shpenzimeve të konstatuara në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke i rakorduar me gjendjen e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.</p>   |
| 3 | <p>Për vitin 2021 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit për detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, ku për vitin ushtrimor 2021 mosrakordimi është në vlerën prej 2,998,286 lekë. Kjo vlerë nuk është evidentuar as në gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.</p>         | faqe 38-58 | e lartë | <p>Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Pustec në mbyllje të vitit 2022 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara (të prapambetura) ndaj të tretëve në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” dhe shpenzimeve të kryera për këto detyrime në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke i rakorduar ato. Për pasaktësitë e rezultuara në këto llogari në mbyllje të vitit 2021 të kryhen sistemimet e nevojshme kontabël, duke i reflektuar ato në bilanc.</p> |
| 4 | <p>Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjendja e llogarisë 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" përfaqëson detyrimin që të tretët i kanë shtetit/bashkisë për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Në këtë rast gjendja e kësaj llogarie është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë që i korespondojnë gjendjes së llogarisë antiparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3</p> | faqe 38-58 | e lartë | <p>Sektori i Financës në Bashkinë Pustec në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit/bashkisë si debitorët, duke i evidentuar në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.</p>   |
| 5 | <p>Nga verifikimi dhe shqyrtimi i veprimtarisë dhe të dhënave në lidhje me procedurat e inventarizimit dhe regjistrimit të asetëve rezultoi se nga Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Asetëve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Pas daljes së VKM nr.48, datë 26.01.2022 për “Transferimin, në pronësi të Bashkisë Pustec, për NJA Pustec, të disa pasurive me vend-ndodhje në zonat kadastrale 2462 dhe 1797” në vitin 2022, nga Bashkia Pustec janë mbajtur vazhdimisht korespondenca me ASHK për identifikimin dhe transferimin e pronave, por</p>  | faqe 58-60 | E lartë | <p>Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në ASHK, Drejtoria Korçë. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pustec dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të</p>   |

|  |                   |                |   |
|--|-------------------|----------------|---|
|  |                   |                | <p>ndërtesave, tokës bujqësore etj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.</p>   |
| <p>6</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se <b>në fund të vitit 2021</b> janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën <b>17,953,280 lekë</b> 11 subjekte të biznesit dhe 1336 taksapagues familjarë, <b>gjatë vitit 2022</b> është krijuar vlerë debitorë shtesë prej <b>1,577,700 lekë</b> dhe <b>në fund të vitit 2022</b> janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën progresive prej <b>19,710,980 lekë</b>, 11 subjekte të biznesit në <b>vlerën</b> 357,192 lekë dhe 1292 taksapagues familjarë në vlerën 19,353,788 lekë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët nuk ka proceduar me masa shtërnguese për arkëtimin e taksave e tarifave vendore. Gjithashtu debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 në vlerën 1,577,700 lekë nuk janë evidentuar në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 neni 24, neni 4 pika 7, neni 89, 90, 91, 93, 94, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104 dhe VKB nr. 43, datë 23.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec”.</p> | <p>faqe 33-38</p> | <p>e lartë</p> | <p>Sektor i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën <b>19,710,980</b> lekë. Gjithashtu të marrë masa për raportimin në Sektorin e Financës të debitorëve, të shtesave apo pakësimeve të vitit ushtrimor dhe shtesat apo pakësimet e vitit paraardhës, me qëllim evidentimin dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.</p> |

### ***1.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit***

#### **Opinionit i auditimit financiar.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Pustec për vitin ushtrimor 2022, në të cilat përfshihen pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të modifikuar** për llogaritë vjetore të vitit 2022 të subjektit Bashkia Pustec, pasi veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi (ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike (kriteret), por konstatohen raste keq klasifikimi të llogarive apo rastet të mospërputhshmërisë, të cilat janë anomali materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore të Bashkisë Pustec.

#### **Baza për opinion:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 265 mijë lekë.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese për pasqyrat financiare të vitit 2022 janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të modifikuar<sup>1</sup>, ku ka rezultuar se anomali të janë materiale, por jo të përhapura** sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

- Gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*” në aktiv të bilancit në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit.

-Gjendja e llogarisë 231“Shpenzime për investime në proces” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2022 konstatohet se 2 kontrata investimesh të pa mbyllura, ku vlera pjesore e paguar prej 159,504,255 lekë duhet ti përkiste

---

<sup>1</sup>Sipas *Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2, fq 141: “Një opinion i kualifikuar/modifikuar duhet të shprehet kur audituesi ka marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit dhe konstaton se ka gabime materiale të pasqyrat financiare ose nëse audituesi nuk mund të marrë evidenca të përshtatshme për aspektet e auditimit. Opinioni i kualifikuar jepet kur anomali të ose kufizimi e fushëveprimit nuk janë aq material dhe të përhapur sa të kërkojë një opinion të kundërt ose një mohim të opinionit. (ISSAI 1700.7)”*.

gjendjes debitoare llog. 231 "Shpenzime për investime në proces" dhe jo gjendjes së llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë.

- Përlllogaritja e amortizimit të aktiveve të llog. 218 "Inventar Ekonomik" është bërë gabim mbi bazën e normës së amortizimit prej 10% dhe jo 20% sa është norma e amortizimit e miratuar dhe për artikullin "kompjuter" jo në masën 25% sic i takon këtij grupaktivesh.

- Gjendja e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Në këtë rast gjendja e kësaj llogarie është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë që i korespondon gjendjes së llogarisë antiparti 468 "Debitorë të ndryshëm" në aktiv të bilancit.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Pustec.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1028/1 Prot., datë 22.11.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Pustec nga data 04.12.2023 deri në datën 29.12.2023, u krye "Auditim Financiar", për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. I. Sh, Përgjegjës Grupi;
2. M. B;
3. S. H;

### **III. 1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar në Bashkinë Pustec kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha



aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

## **II.2. Qëllimi i auditimit:**

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Pustec është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2021, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

## **II.3. Identifikimi i çështjes**

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pustec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

**Pika 1.** Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

**Pika 2.** Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

**Pika 3.** Vlerësimi i raportimit financiar për vitin ushtrimor 2022.

**Pika 4.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## **II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Kryetari i Bashkisë, z. P. K, i cili është edhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe zj. C. N, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi.

## **II.5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Pustec, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **II.6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Pustec është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Pustec. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- **Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:**
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë. e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike”;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”
- Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik urdhri i ministrit Financave nr. 100,

dt. 16.10.2017.

▪ **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, dhe aktet normative që ndryshon këtë ligj.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;
- VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Udhëzimin e MFE nr.27, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023",
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 04, datë 25.01.201 “Për buxhetin e vitit 2021”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**

- Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”.
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

▪ **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

## **II.7. Standardet e auditimit**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

## **II.8. Metodatat e auditimit**

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampionëve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elemente:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Thëksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

### ▪ **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### ▪ **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

### ▪ **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

### ▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### ▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ **Intervista**

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Pustec me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

▪ **Raporte dhe Informacione**

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

▪ **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

• **Praktikat e ndjekura**

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

## II.9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatete këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera tërëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt-Konstatimeve dhe Akt-Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projektraport Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivitet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënime shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### III.1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Pustec

##### III.1.1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Pustec u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta në mbylljen e pasqyrave financiare si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Pustec është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pustec.

Bashkia e re e Pustecit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Maqedoninë etj.

Bujqësia është e përqendruar të agrumet, dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Bashkia Pustec ka një popullsi rreth 5,200 banorë.

Si rezultat i reformës administrative-territoriale nuk ka përfshirë njësi të tjera administrative, pra është vazhdim i ish Komunës Pustec. Veprimtaria e njësisë vendore bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” .

Bashkia Pustec si njësi vendore kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit.





## III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

### III.2.1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundur dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

#### 1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

#### a) *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike;*

Titullari i njësive publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësive publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Pustec nuk disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

#### b) *Politikat menaxheriale dhe stili i punës;*

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se *‘Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave’*. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se *“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike”*. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se *“Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave”*. Grupit të auditimit nuk i është paraqitur urdhri i titullarit në të cilin përcakton ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, si organ i rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar të njësisë publike dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit për MFK. Nga kjo rezulton se për vitin 2022 titullari i Bashkisë Pustec nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik. Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se *“GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike”*. Për sa më sipër, për vitin 2022, nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se *“Kordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës”*.

**c) *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;***

Bashkia Pustec e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18, datë 28.02.2023 *“Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Pustec”*.

Për vitin 2022, Bashkia Pustec nuk ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje.

Bashkia Pustec disponon disa përshkrime pune, por procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* në të cilin përcaktohet se “Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/

pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës”. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për klasifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimit”.

### **ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;**

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” “Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit”. Gjithashtu, Bashkia Pustec nuk disponon një program trajnimi për punonjësit.

## **2. Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”. Për sa më sipër, rezultojnë se Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Bashkia Pustec nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Pustec nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

## **3. Veprimtaritë e kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Pustec, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsisve dhe nxjerrjen e përgjegjësiave.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*”. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Pustec për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

#### **4. Informacioni dhe komunikimi**

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Pustec, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Pustec ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku në nenin 4 përcaktohet se ‘*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*’. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se “*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër*”.

#### **5. Monitorimi**

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcaktohet se “*Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të*

*njesisë që drejtojnë*”. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Pustec nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në nenin 18, pika 1, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “*Nëpunësi autorizues i njesisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njesisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njesisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual*”. Për sa më sipër, për vitin 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Pustec nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Për vitin 2022 nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pustec nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

*Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezulton se strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec nuk kanë zbatuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim tij.*

|  |
|--|
| <b>Titulli gjetjes:</b> Mos zbatim i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. |
|--|

**Situata:**

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së konstatohet se nga Bashkia Pustec, nuk është zbatuar ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, e konkretisht:

-Bashkia Pustec nuk disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

-Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimt për arritjen e tyre.

-Bashkia Pustec e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18, datë 28.02.2023 “*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Pustec*”. Për vitin 2022, Bashkia Pustec nuk ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje.

- Bashkia Pustec disponon disa përsoshkrime pune, por procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me legjislacionin. Gjithashtu, këto përsoshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP. Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve.
- Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji rishu dhe nuk disponon procedurë të menaxhimit të rishut, ku të bëhet analiza dhe kontrolli i rishqeve, si dhe mungojnë raportet e monitorimit të fushave me rish.
- Titullari i Bashkisë Pustec për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.
- Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës.
- Bashkia Pustec nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pustec nuk ka hartuar planin vjetor të trajnimeve.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia Pustec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

**Kriteri:**

Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, neni 8, pika 8/a, 12, pika 3, 16, 21, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të rishut në njësitë publike”, neni 24, 35 i Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përsoshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe “Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore, neni 62 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 4; neni 8.

**Ndikimi:**

Mos zbatim i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke rishuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve financiare publike, si edhe ndikim negativ në performancën e institucionit për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga personat përgjegjës për MFK.

**Rëndësia:** I mesëm

**Për këtë rekomandojmë:**

-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

- Titullari i institucionit të ngrehë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.
- Titullari i institucionit të ndjekë me rigozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

**Shpjegime për observacionin e bërë nga Bashkia Pustec me shkresën nr.prot 116, datë 25.01.2024 në lidhje me këtë pikë sqarojmë se:**

**Pretendimi i subjektit:** Janë paraqitur observacionet në lidhje me Urdhrin për ngritjen e GMS, në datën 19.01.2022, urdhri për ngritjen e grupit të punës për menaxhimin e riskut dhe koordinatorin e riskut datë 10.01.2022. Po kështu është paraqitur Pyetësori i vetëvlerësimit dhe deklarata për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm date 08.05.2023.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me pretendimin se është nxjerrë urdhri për ngritjen e GMS dhe menaxhimin e riskut, sqarojmë se nuk na janë paraqitur observacione dhe dokumente gjatë procesit të auditimit si edhe në fazën e hartimit të aktkonstatimit (afati 7 ditor). Megjithëse në institucionin tuaj janë nxjerrë këto urdhra, këto grupe nuk kanë kryer funksionin e tyre. Merret në konsideratë vetëm nxjerrja e urdhrave.

Në lidhje me përgatitjen e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe dhe deklaratën e sistemeve të kontrollit të brendshëm, sqarojmë se nuk qëndron, pasi nuk mund të plotësohet një deklaratë për sistemet e kontrollit të brendshëm në kushtet kur institucioni nuk ka strukturë të auditit të brendshëm.

### **III.2.1.2. Organizimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm;**

#### **III.2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm**

Nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Pustec, konstatohet se për vitin 2022 nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm, veprim në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe pikën 1, të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Në këto kushte rezulton se aktiviteti ekonomik dhe financiar i këtij institucioni nuk është audituar nga struktura të auditit të brendshëm.

Për realizimin e shërbimit të brendshëm të auditimit me shkresën nr.1326, date 10.10.2023, nga Bashkia Pustec përfaqësuar nga z.P. K. dhe z.E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Bilisht, është nënshkruar Akt Marrëveshja për kryerjen e këtij shërbimi për periudhën 01.01.2024-31.12.2026.

**Titulli gjetjes:** Mungesa e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

#### **Situata:**

Nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Pustec, konstatohet se për vitin 2022 nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm. Për realizimin e shërbimit të brendshëm të auditimit me shkresën nr.1326, date 10.10.2023, nga Bashkia Pustec përfaqësuar nga z.P. K. dhe z.E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Bilisht, është nënshkruar Akt Marrëveshja për kryerjen e këtij shërbimi për periudhën 01.01.2024-31.12.2026.

#### **Kriteri:**

Neni 49 i ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe pika 1, e VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

#### **Ndikimi:**

Aktiviteti ekonomik dhe financiar i këtij institucioni nuk është audituar nga struktura të auditit të brendshëm.

**Shkaku:**

Mungesa e specialistëve të auditit.

**Rëndësia:** I lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për kryerjen e auditimit nga struktura e auditit të Bashkisë Bilisht për veprimtarinë ekonomiko-financiare, referuar Marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Bilisht.

Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr.2, datë 29.12.2023 dhe ngarkohet me përgjegjësi z.P. K.

**III.2.2. Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2022-2024 dhe miratimi i tij dhe gjithë korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2022 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit shpenzimet dhe të ardhurat.
4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.
6. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet të ardhurat etj.).

➤ ***Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore.***

- ***Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024***

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:

- Përrealizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.10, datë 10.01.2022 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 3 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i cili është miratuar me VKB nr.04, datë 09.02.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 165/1, datë 25.02.2021 në



përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

- Nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve dhe të ardhurave të PBA

- Kryetari i Bashkisë nuk ka miratuar udhëzimin e brendshëm nr.1, date 01.04.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024” në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 35/1.

- Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr.36, datë.27.10.2021, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 1049/1, datë 04.11.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024" dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, date 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimit e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZSHH dhe ministritë e linjës. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat. Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr.prot.469, datë 30.03.2022.

• Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 45, datë 23.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1294/3 date 12.01.2022, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr.                      | Emërtimi   | Plani i vitit 2022 |               |
|--------------------------|--|--------------------|---------------|
|                          |  | Të Ardhurat        | Shpenzimet    |
| 1                        | Plani i të ardhurave viti ushtrimor                      | 8 000              |               |
| 2                        | Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar                 | 41 254             |               |
| 3                        | Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale      | 32 512             |               |
| 4                        | Paga (600)   |                    | 44 600        |
| 5                        | Sigurime shoqërore (601)                                 |                    | 7 511         |
| 6                        | Shpenzime operative (602)                                |                    | 24 363        |
| 7                        | Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë                     |                    | 2 292         |
| 8                        | Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike |                    | 3000          |
| <b>Totali i buxhetit</b> |  | <b>81 766</b>      | <b>81 766</b> |

Me Vendim të KB nr.05, datë 20.01.2022 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën

nr.86/2, datë 31.01.2022, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr.                      | Emërtimi   | Të Ardhurat   | Shpenzimet    |
|--------------------------|--|---------------|---------------|
| 1                        | Diferencë nga transfertat e pakushtëzuar                 | 3 543         |               |
| 2                        | Grant i pashperndare(detyrimet e prapambetura)           | 0             |               |
| 3                        | Të ardhurta të trashëguara                               | 5 353         |               |
| 4                        | Të çelura të papërdorura                                 |               |               |
| 5                        | Grant i trashëguar                                       |               |               |
| 6                        | Transferte e pakushtëzuar sektoriale e paperdorur        | 22 867        |               |
| 8                        | Paga (600)   |               | 11 309        |
| 9                        | Sigurime shoqërore (601)                                 |               | 3 288         |
| 10                       | Shpenzime operative (602)                                |               | 11 085        |
| 11                       | Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë                     |               | 1 058         |
| 12                       | Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike |               | 5 023         |
| 13                       | Investime ne proces                                      |               |               |
| <b>Totali i buxhetit</b> |  | <b>31 763</b> | <b>31 763</b> |

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 81,766 mijë lekë dhe me trashëgimet e fondeve në vlerën 31,763 mijë lekë.

- *Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:*

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

|   | Emërtimi   | Plan fillestar 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi      |
|---|--|---------------------|---------------------|----------------|
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)            | 52 111              | 48 466              | 3 645          |
| 2 | Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif) | 26 655              | 45 134              | -18479         |
| 3 | Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)                           | 3000                | 5 500               | -2500          |
| 4 | Investime nga FZSH   |                     |                     |                |
|   | <b>Total I planit fillestar</b>  | <b>81 766</b>       | <b>99 100</b>       | <b>-17 334</b> |
|   | <b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>  |                     |                     |                |
| 5 | Investime grant i kushtëzuar   |                     |                     |                |
| 6 | Shpenzime për pagat (600+601)  |                     |                     |                |
| 7 | Shpenzime (602.604.609)  |                     |                     |                |
| 8 | Grant i kushtëzuar (230-231) FZHR  |                     |                     |                |
| 0 | <b>Gjithsej</b>  | <b>81 766</b>       | <b>99 100</b>       | <b>-17 334</b> |

**Burimi:** Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej -17,334 mijë lekë nën tavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej -17,334mijë lekëe rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2022) i përket shpenzimeve në llogarive të 600 dhe 601, që është vlera e shtuar nga akordimi i fondit të transfertes sektoriale per financimin e shtesës së pagave për funksionet e kaluara ne varësi në Bashkisë. Këto fonde nuk janë planifikuar saktë në mënyrë të përafërt, por është bërë planifikim i përafërt, pasi nuk dihej transfertat.

- *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Korçë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e

bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Pustec dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetivjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Pustec.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

| Buxheti fillestar 2022 |            | Ndryshime gjatë vitit 2022                    |           |                     |           |                  |           |
|------------------------|------------|---|-----------|---------------------|-----------|------------------|-----------|
| Nr./date               | Vlerë      | Akti nr/datë                                  | Vlera     | Shtesa art          | Shuma     | Pakësim art.     | Shuma     |
| Nr.45dt<br>23.12.2022  | 81,767,063 | VKB nr.14dt 03.03.2022 pagesë TVSH Net Met    | 1,300,000 | 231 investime       | 1,300,000 | 230 investime    | 1,000,000 |
|                        |            | U-T nr.112 dt.27.05.2022 page aparat/shpërbli | 50,000    | 606 transf individe | 50,000    | 602 shp operat   | 300,000   |
|                        |            | VKB nr.26 dt.02.06.2022 Bl. Mjet kullimi      | 5,000,000 | 231 investime       | 5,000,000 | 600 paga         | 50,000    |
|                        |            | VKB nr.27 dt.02.06.2022 Bl.Paisje MZSH        | 5,000,000 | 231 investime       | 5,000,000 | 602 shp operat   | 5,000,000 |
|                        |            | VKB nr.41 dt.28.06.2022 Bl.Paisje MZSH        | 400,000   | 231 investime       | 400,000   | 602 shp operat   | 400,000   |
|                        |            | U-T nr.157 dt.02.09.2022 Page e Kontribute    | 150,000   | 601 Sigurime shoq   | 150,000   | 600 paga         | 150,000   |
|                        |            | VKB nr.39 dt.24.08.2022 Rikonstruksion perroi | 1,000,000 | 231 investime       | 850,000   | 231 investime    | 1,000,000 |
|                        |            |   |           | 231 investime       | 150,000   |                  |           |
|                        |            | VKB nr.41 dt.24.08.2022 Energji elektrike     | 600,000   | 602 shp operat      | 600,000   | 604 tran individ | 600,000   |

**Burimi:** Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Pustec

**Konkluzion:** Nga sa më sipër konstatohet se, për vitin 2022 janë kryer 6 ndryshime me VKB dhe 2 me urdhër titullari, të cilat tregojnë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Korçë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Korçë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2022, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Korçë konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

| Nr. | Emërtimi   | 2022           |                |           |
|-----|--|----------------|----------------|-----------|
|     |  | Plan           | Fakt           | Real.%    |
| 1   | Paga 600   | 55116          | 44325          | 80        |
| 2   | Sigurime shoqërore 601                             | 9758           | 7413           | 76        |
| 3   | ShP. Operat 602+ F. Rezervë +606 transfert individ | 25155          | 13335          | 53        |
| 4   | Nd/Ekonom invalid 606                              | 19090          | 17374          | 91        |
| 5   | Investime (230/231 )                               | 79699          | 65820          | 83        |
| 6   | Mjete ne ruajtje 466                               | 0              | 233            |           |
| 11  | Fond i emergjencave civile min 17 (604)            | 1881           | 1702           | 90        |
|     | <b>Totali</b>                                      | <b>190,699</b> | <b>150,202</b> | <b>79</b> |

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2022 fondet** janë realizuar 150,202 mijë lekë nga 190,699 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 79%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen, sipas nevojave që ka Bashkia Pustec. Në këtë masë realizim ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

- Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 53%, gjë e cila tregon për një planifikim të fryrë të këtij artikulli shpenzimesh të pa argumentuar.
- Shpenzimet për investime llog.231 nga buxheti i Bashkisë, si dhe transfertat e kushtëzuar janë realizuar në masën 83%. Realizimin në këtë masë ka arritur si rezultat i shtesës së planit të investimeve nga shtesa e buxhetit sipas aktit normativ nr.17, datë 01.12.2022, si dhe ndryshimeve në buxhet gjatë vitit, të cilat janë bërë me VKB përkatëse.
- Shpenzimet për paga (art 600) në masën 80% dhe shpenzimet për sigurime shoq/shëndet. (art 601) në masën 76%, kjo për faktin se nuk janë plotësuar vendet e punës.

**Konkluzion:** Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë investimet, ku zeri kryesor është projekti me objekt “Furnizim me ujë Bashkia Pustec”, i ndjekur nga shpenzimet për paga e sigurime personeli. Këta tregues paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | EMËRTIMI                | Përqindja ndaj totalit |
|-----|-------------------------|------------------------|
|     |                         | Viti 2022              |
| 1.  | Investime               | 34.5%                  |
| 2.  | Shpenzime për paga +sig | 27%                    |

- Miratimi i realizimit faktik të buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Pustec është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2022 është miratuar me vendim të KB nr.07, datë.26.01.2022.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2022 është në total në shumën 443 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar i vitit buxhetor me VKB nr.45, datë.23.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Korçë dhe është përdorur e gjithë shuma sipas vendimeve të KB.

Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 443 mijë lekë, konkretisht:

- Me V.K.B nr.11 datë 24.02.2022, konfirmuar në Prefekturë me shkresën nr.216/1prot datë.28.02.2022 mbështetje financiare në vlerën 301 mijë lekë;

- Raportet e Monitorimit.

**Konkluzion:** Për vitin 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore, por vetëm raport vjetor për monitorimin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh. Raporti i monitorimit vjetor për

vitin 2022 është hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore" dhe është dërguar me e-mail në MFE. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, me ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", pikat 10, 12, 28, 29, 48.

➤ ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave.***

Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të e buxhetit" pika 106, në të cilën përcaktohet se: "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

• ***Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara***

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr... prot datë 15.02.2023 jepen në tabelën si më poshtë, në të cilën detyrimet e papaguara të raportuara në fund të vitit 2021 është 1.2 milion lekë dhe në fund të vitit 2022 janë në vlerën 147,866,325 lekë, ku 1,525,535 lekë janë detyrime për fatura të palikujduara për mallra e shërbime, 146,064,990 lekë janë për fatura të papaguara për investimin e furnizimit me ujë të Bashkisë Pustec dhe 275,800 lekë page për një rast të detyrimeve të lindura për vendim gjyqësor të 1 punonjësi për ndërprerje të marrëdhënie të punës me pa të drejtë.

| N.R        | Emërtimi                  | Stoku në vlerë në lekë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|------------|---------------------------|------------------------|--|--|
| <b>I</b>   | <b>Borxhe (a+b)</b>       | <b>0</b>               |  |  |
| \          | <b>Hua sfatgjatë</b>      | <b>0</b>               |  |  |
| a,1        | Principali                | 0                      |  |  |
| a,2        | Interesi                  | 0                      |  |  |
| <b>b</b>   | <b>Hua afatshkurtër</b>   | <b>0</b>               |  |  |
| b,1        | Hua                       | 0                      |  |  |
| b,2        | Overdrafte                | 0                      |  |  |
| b,3        | Kredi të furnitorëve      | 0                      |  |  |
| <b>II</b>  | <b>Detyrime (a+b+c)</b>   | <b>147,866,325</b>     |  | <b>282.26%</b>                                   |
| <b>a</b>   | <b>Shpenzime korrente</b> | <b>1,525,535</b>       |  |  |
| a.1        | Mallra dhe shërbime       | 1,473,035              |  |  |
| a.2        | Paga dhe sigurime         | 0                      |  |  |
| a.3        | Të tjera                  | 52,500                 |  |  |
| <b>b</b>   | <b>Shenzime kapitale</b>  | <b>146,064,990</b>     |  |  |
| b,1        | Insitucione buxhetore     | 146,064,990            |  |  |
| b,2        | Subjekte private          |                        |  |  |
| <b>c</b>   | <b>Vendime gjyqësore</b>  | <b>275,800</b>         |  |  |
| c,1        | Marrëdhënie pune          | 227,800                |  |  |
| c,2        | Mallra dhe shërbime       | 48,000                 |  |  |
| c,3        | Investime                 |                        |  |  |
| c,4        | Të tjera                  |                        |  |  |
| <b>III</b> | <b>Totali (I+II)</b>      | <b>147,866,325</b>     | <b>52,386,732</b>                              | <b>282.26%</b>                                   |

Nga analiza e vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022 krahasuar me analizën e detyrimeve të pa likujduara sipas evidentimit në kontabilitet në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2022 Bashkia Pustec ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 146,181,288 lekë, e cila nuk rakordon me Raportimin në MFE për vlerën 1,685,037 lekë. Peshën më të madhe e zënë detyrimet, që rrjedhin nga detyrimet e krijuara për fatura të mbërritura në Bashki për projektin e investimit “Furnizim me ujë, Bashkia Pustec” gjatë vitit 2022 në vlerën 146,020,720 lekë, pasi nuk janë paguar sepse financimi i tyre do të alokohet nga AKUM në vitin e tretë të PBA 2022-2024, pamvarësisht se punimet sipas kontrataës dhe amendimit të saj janë mbyllur në datë 06.04.2023. Kontrata fillestare është lidhur me datë 08.04.2021 me afat 18 muaj dhe amendimi i kontratës me afat 6 muaj. Ndërsa pjesa tjetër në vlerën 72,494 lekë i takon detyrimeve që ka Bashkia ndaj 47 individëve për ndihmë ekonomike detyrime të krijuara që nga vitet 1998 dhe vlera prej 88,074 lekë e emërtuar të tjera është e paanalizuar, pasi ka mungesë dokumentacioni.

Krijimi dhe akumulimi i detyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

### **Vështirësia Financiare**

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluar*) në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 147,866,325 lekë fatura të cilat nuk mund të likujdohen, pasi vlerën më të madhe të tyre prej 146,020,720 lekë e përbëjnë faturat e mbërritura për situacione për punime të kryera të ndërtimit të Ujssjellsit, ku financimi nga AKUM është shtrirë mbi 2-3 vite. Ndërsa faturat e pa likujduara të Bashkisë me burim financimi të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar janë në vlerën 1,801,335 lekë, vlerë e cila përbën dhe stokun e detyrimeve për vitin buxhetor 2022. Pësia specifike e stokut të detyrimeve të papaguara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 1.05% kundrejt fondeve të miratuara 171,609,000 lekë, duke përjashtuar transfertën e kushtëzuar për ndihme ekonomike dhe invaliditetin. Kjo situatë tregon se, Bashkia Pustec nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- *Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.*

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Pustec.

- Për **vitin 2022** janë planifikuar fonde për investime në shumën 79,699 mijë lekë (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transfershfaqja sektoriale + të ardhura ministria e linjës AKMC ), realizuar dhe likujduar në vitin 2022 në vlerën 65,820 mijë lekë. Realizimi në masën 83% i investimeve ka ardhur si rezultat i mospasjes në dispozicion të fondeve. Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar dhe janë miratuar me VKB për secilin rast. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| Nr. | Objekti i kontratës   | Fond Planifikim   | Kontrata me subjektin     |        |                        | Paguar para vitit 2022 | Paguar Viti 2022  | Mbetja 31.12.2022  | Komente          |
|-----|---|-------------------|---------------------------|--------|------------------------|------------------------|-------------------|--------------------|------------------|
|     |   |                   | Datë lidhjes se kontratës | Afati  | Vlerë kontrate me TVSH |                        |                   |                    |                  |
| 1   | <b>Financuar nga Bashkia</b>  |                   |                           |        |                        |                        |                   |                    |                  |
| 2   | Blerje Eskavator  | 5,000,000         | 08.09.2022                | 5 dite | 4 668 000              |                        | 4,668,000         | -                  | Perfunduar       |
| 3   | Blerje mjete per MZSH   | 5,000,000         | 30.11.2022                | 5 dite | 3 936 000              |                        | 3,936,000         | -                  | Perfunduar       |
| 4   | Mbikqyrje Objekti Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Pustec, Basjka Pustec | 585,938           | 25.11.2022                | 6 muaj | 560 463                |                        | -                 | 560 463            | Punime viti 2023 |
|     | Blerje paisje zyresh  | 400,000           |                           |        | 268,680                |                        | 268,680           |                    |                  |
|     | Bl. Akteve te Qendrueshme   | 700,000           |                           |        |                        |                        |                   |                    |                  |
|     | Bl. Akteve te Qendrueshme   | 1,750,000         |                           |        |                        |                        |                   |                    |                  |
|     | Pagesë TVSH e bashkfinac per ndricim fotovoltaike dhe Muzeu I S.Spases    | 3,228,000         |                           |        |                        |                        | 3,086,648         |                    |                  |
|     | Pagesë TVSH për projekt smart-kulture projekt I huaj                      | 2,645,000         |                           |        |                        |                        | 2,280,816         |                    |                  |
|     |   | <b>19,308,938</b> |                           |        | <b>9,164,463</b>       |                        | <b>14,240,144</b> | <b>560,463</b>     |                  |
|     | <b>Ministria e mbrojtjes AKMC</b>   |                   |                           |        |                        |                        |                   |                    |                  |
| 1   | Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Pustec, Bashkia Pustec                  | 25,000,000        | 10.11.2022                | 6 muaj | 25 475 580             |                        | 16 079 580        | 9 396 000          | Punime viti 2023 |
|     |   | <b>25,000,000</b> |                           |        | <b>25 475 580</b>      |                        | <b>16 079 580</b> | <b>9 396 000</b>   |                  |
|     | <b>Financuar nga AKUM</b>   |                   |                           |        |                        |                        |                   |                    |                  |
| 2   | Furnizim me ujë B. Pustec (Ujsjell)                                       | 35,000,000        |                           |        | 540,799,533            | 108,199,198            | 35,000,000        | <b>397,600,335</b> |                  |
|     | Mbikqyrje Furn. Me ujë B.Pustec   | 500,000           |                           |        | 4,324,340              |                        | 500,000           | <b>3,824,340</b>   |                  |
|     |   | <b>35,500,000</b> |                           |        |                        |                        | <b>35,500,000</b> |                    |                  |
|     | <b>Totali i investimeve</b>   | <b>79,198,585</b> |                           |        |                        |                        | <b>65,819,724</b> |                    |                  |

Bashkia Pustec ka programuar dhe realizuar projekte investimesh të reja dhe në vazhdim sipas burimit të financimit:

**a. Me fondet e veta.**

1. Blerje Eskavator me vlerë kontrate 4,668,000 lekë dhe financuar në vitin 2022 në vlerën 4,668,000 lekë .
2. Blerje mjete per MZSH me vlerë kontrate 3,936,000lekë dhe financuar në vitin 2022 në vlerën 3,936,000lekë.

**b. Me financim nga Ministria e mbrojtjes Agjencia Kombëtare Mbrojtjes Civile:**

1. Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Pustec, Bashkia Pustec me vlerë kontrate 16,079,580 lekë dhe financuar në vitin 2022 në vlerën 16,079,580 lekë.
2. Mbikqyrje Objekti Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Pustec, Basjka Pustec me vlerë kontrate 560,463 lekë dhe financuar në vitin 2022 në vlerën 560,463 lekë.

**a. Me financim nga AKUM:**

1. Furnizim me ujë Bashkia Pustec me vlerë kontrate 540,799,533 lekë dhe financuar në vitin 2021-2022 në vlerën 143,199,198lekë.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e projekteve të investimeve rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Korçë. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Korçë dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë, me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

| Nr | Emertimi   | 2022           |                |            |
|----|--|----------------|----------------|------------|
|    |  | Plan           | Fakt           | Real.%     |
| 1  | <b>Paga 600</b>  | <b>55,116</b>  | <b>44,323</b>  | <b>80</b>  |
|    | grant I kushtezuar   | 642            | 556            | 85         |
|    | grant I pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale                      | 50,893         | 40,662         | 80         |
|    | te ardhura   | 3 581          | 3 105          | 87         |
| 2  | <b>Sigurime shoqërore 601</b>                                      | <b>9,756</b>   | <b>7,410</b>   | <b>76</b>  |
|    | grant I kushtezuar   | 96             | 83             | 86         |
|    | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike                       | 9,190          | 6,911          | 75         |
|    | te ardhura   | 470            | 416            | 88         |
| 3  | <b>Shpenz.operative 602+ F.rezerve</b>                             | <b>25,644</b>  | <b>13,299</b>  | <b>52</b>  |
|    | grant I kushtezuar   |                |                |            |
|    | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike                       | 24,234         | 12,346         | 51         |
|    | te ardhura   | 1,410          | 953            | 68         |
| 4  | <b>K.Qarkut Transferime 604</b>                                    | <b>1,701</b>   | <b>1,701</b>   | <b>100</b> |
|    | grant  | 1,400          | 1,400          | 100        |
|    | grant I kushtezuar   | 301            | 301            | 100        |
|    | te ardhura   |                |                |            |
| 5  | <b>Nd ekonomike invalid 606 ,bonus strehimi ,ndihma financiare</b> | <b>18,880</b>  | <b>17,183</b>  | <b>91</b>  |
|    | grant I kushtezuar   | 16,867         | 15,758         | 93         |
|    | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike                       | 1,789          | 1,201          | 67         |
|    | te ardhura   | 224            | 224            | 100        |
| 6  | <b>Investime 230-231</b>   | <b>79,699</b>  | <b>65,820</b>  | <b>83</b>  |
|    | grant I kushtezuar   | 25,475         | 16,080         | 63         |
|    | grant I kushtezuar AKUM  | 35,500         | 35,500         | 98         |
|    | grant I pakushtezuar + trasnsferta specifike                       | 18,723         | 14,240         | 76         |
|    | te ardhura   |                |                |            |
|    | <b>Totali Bashkia Pustec</b>                                       | <b>190,796</b> | <b>149,736</b> | <b>78</b>  |
|    | <b>Mjete në ruajtje</b>  |                | <b>233</b>     |            |
|    | <b>Total Bashkia Pustec +466 mjete ne ruajtje</b>                  | <b>190,796</b> | <b>149,969</b> | <b>78</b>  |

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 4,698 mijë lekë ose në masën 3.35%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 76,760 mijë lekë ose në masën 51.26%, nga transferta e kushtëzuar në shumën 67,977 mijë lekë ose në masën 45.39%.

**Titulli gjetjes:** Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2022

**Situata:**

Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 *u konstatua se:*

**a.** Realizimi i buxhetit për *vitin 2022* është 150,202 mijë lekë nga 190,699 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 79%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i artikullit 602 “Shpenzime operative” në masën 53%, i artikullit të pagave dhe sigurimeve në masën 80% si dhe i artikullit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 83%, artikuj buxhetorë të planifikuar përtej burimeve të financimit.

**b.** Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të trashguara nga viti paraardhës. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 147,866,325 lekë, që përbëhet nga vlera prej 146,020,720 lekë e projektit të ndërtimit të ujsjellsit që financohet në 2-3 vite, dhe vlera prej 1,801,335 lekë i përket stokut të detyrimeve për fatura të palikujduara me burim financimi të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar e Bashkisë. Stoku i detyrimeve të papaguara është në masën 1.05 % të shpenzimeve të planifikuara. Detyrimet e papaguara të raportuara në MFE nuk rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, për vlerën 1,685,037 lekë.



c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 96.65% nga Buxheti i Shtetit (transfera e pakushtëzuar dhe transfera e kushtëzuar e transfera specifike) dhe 3.35% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësia vendore nga burimet të tjera.

d. Për vitin 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore, por vetëm raport vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit në nivel programesh.

**Kriteri:**

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 52,65; ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42,48; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

**Ndikimi:**

Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti, realizim jo shumë të mirë të të ardhurave si dhe raportim jo i plotë e detyrimeve të papaguara.

**Shkaku:**

Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash dhe moslikujdimi detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

**Rëndësia:** I mesëm

**Për këtë rekomandojmë:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe në bashkëpunim me Menaxhimerët e Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë reale dhe të argumentuar, si dhe të parashikohet mbulimi me fonde i detyrimeve të prapambetura. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Të përgatiten dhe të paraqiten pranë Këshillit Bashkiak raportet e monitorimit periodik të realizimit të buxhetit, për matjen e performancës financiare, realizimin e produkteve dhe objektivave për çdo program të përcaktuar në vitin ushtrimor.

**III.2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.** Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

- Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pustec në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2022 janë 25 subjekte biznesi dhe institucione**, nga të cilat 18 subjekte të biznesit të vogël dhe 1 subjekte të biznesit të madh, Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Pustec në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| NR | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja në fillim | Regjistrime të Reja | Mbyllur Aktiviteti | Gjendja në fund të vitit | Biznese të palicencuar deri ne fund te vitit ushtrimor |
|----|----------------|------|-------------------|---------------------|--------------------|--------------------------|--|
|----|----------------|------|-------------------|---------------------|--------------------|--------------------------|--|

|   |                 |      |    |   |   |    |   |
|---|-----------------|------|----|---|---|----|---|
| 1 | BIZNESI I VOGEL | 2022 | 18 | 1 | 1 | 18 | - |
| 2 | BIZNESI MADH    | 2022 | 1  | 0 | 0 | 1  | - |
| 3 | INSTITUCIONE    | 2022 | 6  | 0 | 0 | 6  | - |
|   | TOTALI          | 2022 | 25 | 1 | 1 | 25 | - |

• *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

**Për vitin 2022**, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Pustec është miratuar me VKB nr. 43, datë 23.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec”. Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Korçë, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Pustec për 2022 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| Nr | Emertimi                             | Plan             | Fakt             | %      |
|----|--------------------------------------|------------------|------------------|--------|
|    | <b>Te ardhura tatimore</b>           |                  |                  |        |
| 1  | Taksë ndertese                       | 1,187,200        | 751,105          | 63.2   |
| 2  | Taksë toke                           | 1,302,000        | 654,224          | 50.2   |
| 3  | Taksë trualli                        | 70,200           | 53,718           | 76.5   |
| 4  | Taksë Tabele                         | 8,000            | 7,840            | 98     |
| 5  | Taksë nga ndert.e reja(lega)         | 1,222,000        | 2,466,517        | 201    |
| 6  | Taksë rruge mjete transporti         | 400,000          | 307,200          | 76.8   |
| 7  | Tatim fitimi                         | 0                | 0                | 0      |
|    | <b>SHUMA</b>                         | <b>4,189,400</b> | <b>4,240,604</b> | 101.2  |
|    | <b>Te ardhura jo tatimore</b>        |                  |                  |        |
| 8  | Tarifë pastrimi f+subjektet          | 1,800,000        | 1,202,443        | 66.8   |
| 9  | Tarifë ndricimi f+subjektet          | 800,000          | 550,913          | 68.8   |
| 10 | Tarifë të ndryshe ne bashki          | 400,600          | 190,500          | 47.5   |
| 11 | Të ardhura nga qirate                | 800,000          | 330,355          | 41.2   |
| 12 | Kamatvonese                          | 10,000           | 4,780            | 48.7   |
| 13 | Tatim të ardhura personale           | 0                | 1,037,322        | paplan |
| 14 | Te tjera shitjet mallra dhe sherbime | 0                | 83,680           | paplan |
|    | <b>SHUMA</b>                         | <b>3810600</b>   | <b>3,399,993</b> | 89.2   |
|    | <b>TOTALI</b>                        | <b>8000000</b>   | <b>7,640,597</b> | 95.5   |

Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Pustec paraqitet në masën 95.5%, nga 8,000,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 7,640,597 lekë. Në këtë realizim kanë ndikuar pagesat e debive të viteve të kaluara në vlerën 1,592,534 lekë si dhe të ardhurat nga taksat e ndara të realizuara në shumën 4,240,604 lekë nga 4,189,400 lekë të planifikuara ose në masën 101.2% , ku përfshihen (Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme , Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, Taksa mbi të ardhurat personale. Pra kemi një planifikim jo të saktë të taksave për familjarët, pasi për një pjesë e taksapaguesve familjarë mungojnë të dhënat personale të përditësuara. Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, kështu :

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** është realizuar 2,466,517 lekë nga 1,222,000 lekë e planifikuar ose në masën 201%,

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të planit si:

-**Taksa mbi ndërtesën** është realizuar 751,105 lekë nga 1,187,200 e planifikuar ose në masën 63.2%,

-**Taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar 654,224 leke nga 1,302,000 lekë e planifikuar ose në masën 50.2%,

-**Taksa mbi truallin** është realizuar 53718 lekë nga 70,200 lekë e planifikuar ose në masën 76.5%,

-**Taksa tabele** është realizua 7,840 lekë nga 8,000 lekë e planifikuar ose në masën 98%,

**-Tarifa e pastrimit** është realizuar 1,202,443lekë nga 1,800,000 lekë e planifikuar ose në masën 66.8%,

**-Tarifa e ndricimit** është realizuar 550,913lekë nga 800,000 lekë e planifikuar ose në masën 68.8%,

➤ Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor:

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022.

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të punimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Pustec, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh**, duke përfshirë biznesin, personat fizik, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, tarifë pastrim-ndricim, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021** vlera debitorëve është **305,452 lekë** dhe në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **357,192 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në Aneksin bashkëlidhur.

| Nr            | LLOJI I DEBITOREVE | Periudha deri me 31.12.2022 |   |                                   |                |               |                                   |
|---------------|--------------------|-----------------------------|---|-----------------------------------|----------------|---------------|-----------------------------------|
|               |                    | Lloji i Detyrimeve          |   | Shuma e Detyrimeve Progresiv 2021 | Shtesa         | Pakesime      | Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022 |
| 1             | Biznes i Vogel     | Taksa e Tarifa vendore      | Tarife pastrimi, ndricimi, Takse ndertese, Takse table  | 201632                            | 38883          | 36653         | 203862                            |
| 2             | Biznes i Madh      | Taksa e Tarifa vendore      | Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, reklame, Tarife leje e licenca, Takse ndertese, Takse Tabele, Qera fondi pyjor kullusor | 59820                             | 36510          |               | 96330                             |
| 3             | Istutic Shtetore   | Taksa e Tarifa vendore      |   | 44000                             | 31000          | 18000         | 57000                             |
| <b>TOTALI</b> |                    |                             |   | <b>305,452</b>                    | <b>106,393</b> | <b>54,653</b> | <b>357,192</b>                    |

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Pustec paraqitet:

**Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 106,393 lekë nga të cilat:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në shumën 75393 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 31000 lekë;

Në uljen e debitorëve ka ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 54653 lekë.

**Për vitin 2022 gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën 357,192 lekë:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, rezultojnë në vlerën totale **300,192 lekë për 11 biznese** (taksa-tarifa );
- Detyrime nga institucione publike në vlerën **57,000 lekë;**

- **Masat e marra për uljen e borxhit**

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e paguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të paguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 9 tatimpaguesve debitorë për vitin 2021 dhe bllokime për vitin 2022.

Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët që rezultojnë se gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **2 subjekte në vlerën 36,653 lekë**.

- Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Pustec taksohen gjithësej 1430 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen, pasqyrohet si më poshtë:

| Nr | Bashkia PUSTEC | 2022   |  |
|----|----------------|--|--|
|    |                | Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022 |  |
|    |                | Nr   |  |
|    | Bashkia Pustec | 1430   |  |
|    | <b>TOTAL</b>   | <b>1430</b>  |  |

Debitorët "Familjar" të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec.

Numri i familje në Bashkinë Pustec, të cilat rezultojnë debitorë në një ose disa taksa/tarifa paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Bashkia Pustec | 2022                                     |  |   |                                |
|----|----------------|--|--|---|--------------------------------|
|    |                | Familje Debitorë në fillim të vitit 2022 | Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022 | Familjet debitorë të krijuara brenda vitit 2022 | Progressive deri në vitin 2022 |
|    |                | Nr                                       | Nr   | Nr  | Nr                             |
|    |                | 1336                                     | 1430   | 1183  | 1291                           |
|    | <b>TOTAL</b>   | <b>1336</b>                              | <b>1430</b>  | <b>1183</b>                                     | <b>1291</b>                    |

Ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit, pastrim, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| Nr.           | Loji i Taksës dhe Tarifës | Debitor deri në fillim të vitit | Maturimi         | Arkëtimet      | Debitorët krijuar brenda vitit | Arkëtuar debitorë | Totali Debi       |
|---------------|---------------------------|---------------------------------|------------------|----------------|--------------------------------|-------------------|-------------------|
|               |                           | 2022                            | 2022             | 2022           | 2022                           | 2022              | Progressive       |
| 1             | Ndërtesë                  | 2745292                         | 960504           | 248207         | 712297                         | 234175            | 3223414           |
| 2             | Tarife Pastrimi           | 5788000                         | 1388800          | 376800         | 1012000                        | 545100            | 6254900           |
| 3             | Tarife Ndricim            | 3638600                         | 723000           | 198700         | 524300                         | 322100            | 3840800           |
| 4             | Takse Trualli             | 146545                          | 36244            | 7258           | 28986                          | 12660             | 162871            |
| <b>Totali</b> |                           | <b>12,318,437</b>               | <b>3,108,548</b> | <b>830,965</b> | <b>2,277,583</b>               | <b>1,114,035</b>  | <b>13,481,985</b> |

Referuar tabelës së mësipërme rezultojnë se vlera debitorë e kategorisë "Familjar" për taksat dhe tarifave vendore, në krahasim me fillimin e vitit 2022 është shtuar me 1,163,548 lekë ku vlen të theksohet se në këtë bashki kemi një rritje progresive të këtij detyrimi kryesisht për shkak të migrimit dhe emigrimit të shumtë të popullsisë.

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se në fund të vitit 2022 në Bashkinë Pustec, janë gjithësej 1291 familje debitorë për vlerën 13,481,985 lekë, nga të cilat 1183 familje për vlerën 2,277,583 lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022.

- Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas Bashkia Pustec janë 1016.2 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë.

Konkretisht planifikimi për vitin 2022 i taksës së tokës bujqësore nga Bashkia Pustec, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

| Kategoria e tokës                           | Sip/HA        | Vlera/Ha | Zbritja 30% | Plani/Lekë       |
|---|---------------|----------|-------------|------------------|
| Kategoria IV                                | 164.2         | 2300     | 1610        | 264362           |
| Kategoria V                                 | 251           | 1900     | 1330        | 333830           |
| Kategoria VI                                | 451.5         | 1600     | 1120        | 505680           |
| Kategoria VII                               | 149.5         | 1400     | 980         | 146510           |
| <b>e. Totali sip. ha sipas planifikimit</b> | <b>1016.2</b> |          |             | <b>1,250,382</b> |

Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

Në fund të vitit 2022 rezulton se vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është 5,871,803 lekë në Bashkisë Pustec, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 598,412 lekë. Gjatë vitit 2022 janë gjithsej 1167 familje debitore për vlerën 1,022,258 lekë. Jane shperndare njoftime vlersim te cdo tatimpaguesi per taksat dhe tarifate vendore prane Bashkise Pustec.

Spektori i Tatim-Taksave ka mare masa per mbledhjen e debitoreve duke mos i sherbyer asnje debitori pa shlyer detyrimet prane Bashkise Pustec. Ne Bashkine Pustec nr i familjeve rezidente sa vjen dhe paksohet dhe ata qe kanë ngelur jane familje pensionistësh me të ardhura të pakta.

| Debitor toka bujqësore 2022 |  |                                       |                       |                          |                  |
|-----------------------------|--|---------------------------------------|-----------------------|--------------------------|------------------|
|                             | Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022 | Debitorë krijuar në vitin 2022 (Lekë) |                       |                          | DEBIA PROGRESIVE |
|                             |  | Familje me tokë bujqësore             | Familje debitore (Nr) | Familje debitore (vlerë) |                  |
| BASHKIA PUSTEC              | 5273391  | 1407                                  | 1167                  | 1022258                  | 5871803          |
| <b>TOTALE</b>               | <b>5,273,391</b>                                   | <b>1407</b>                           | <b>1167</b>           | <b>1,022,258</b>         | <b>5,871,803</b> |

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor është mbajtur aktkonstatimi nr.5, datë 29.12.2023 dhe ngarkohet me përgjegjësi z. Q. Th. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe zj.E A. me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Titulli gjetjes:** Mos ndjekje e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitore.

**Situata:**

Nga auditimi i të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se **në fund të vitit 2021** janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën **17,953,280 lekë** 11 subjekte të biznesit dhe 1336 taksapagues familjarë, **gjatë vitit 2022** është krijuar vlerë debitore shtesë prej **1,577,700 lekë** dhe **në fund të vitit 2022** janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën progresive prej **19,710,980 lekë**, 11 subjekte të biznesit në **vlerën** 357,192 lekë dhe 1292 taksapagues familjarë në vlerën 19,353,788 lekë. Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët nuk ka proceduar me masa shtërnguese për arkëtimin e taksave e tarifave vendore. Gjithashtu debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 në vlerën 1,577,700 lekë nuk janë evidentuar në kontabilitet.

**Kriteri:**

Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 neni 24, neni 4 pika 7, nenet 89, 90, 91, 93, 94, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimin të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve

tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104 dhe VKB nr. 43, datë 23.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec” .

**Ndikimi:**

Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:**

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftime vlerësimit tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 19,653,980 lekë. Gjithashtu të marrë masa për raportimin në Sektorin e Financës të debitorëve, të shtesave apo pakësimeve vitit ushtrimor dhe shtesat apo pakësimet e vitit paraardhës, me qëllim evidentimin dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.

*Shpjegime për observacionin e bërë nga Bashkia Pustec me shkresën përcjellëse nr.prot 116, datë 25.01.2024 në lidhje me këtë pikë sqarojmë:*

***Pretendimi i subjektit:** Janë dërguar njoftime subjekteve të biznesit për shumën 261,452 lekë dhe familjarëve për shumën 17,591,828 lekë. Janë bërë urdhër-blokime të llog. banakare me shkresën nr.179, datë 07.02.2023. Është bërë kërkesë DRTRR, Korçë për vendosjen e barrës siguroese me shkresën nr.180, datë 07.02.2023. Sektori i Tatim-Taksave ka marrë masa për mbledhjen e debitorëve, duke mos i shërbyer asnjë debitori pa shlyer detyrimet pranë bashkisë Pustec, gjë e cila ka ndikuar në uljen e debitorëve në shumën 15,523,567 lekë në datë 31.12.2023.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket këtij observacioni, sqarojmë se konfirmohen edhe një herë konstatimet e grupit të KLSH dhe shpjegimet e bëra nga ana e subjektit janë të karakterit justifikues dhe në mungesë të argumentit ligjor. Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë.*

**III.2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.**

- 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njesisë;
- 3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumenta kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Korçë në mbyllje të vitit buxhetor 2022.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Pustec” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

• ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Pustec për vitin 2022 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete.

• ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Korçë për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot.963, datë 25.07.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Pustec dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjesi Finances. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të këtyre detyrave.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferencë. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditaret në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përkrahja me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Pergjegjesi i Finances dhe Buxhetit. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, në disa raste nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;



**Konkluzion:** Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

**Totali i Aktivit** për vitin 2022 është në vlerën 577,210,374 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

| Formati nr.1 |                     | Aktivi i Bilancit 2022                               | Në lekë             |                    |
|--------------|---------------------|--|---------------------|--------------------|
| Nr. Reshti   | Referenca Llogarive | EMERTIMI   | Viti ushtrimor 2022 | Viti Paraardhes    |
| 1            | A                   | <b>A K T I V E T</b>                                 | <b>577,210,374</b>  | <b>334,669,441</b> |
| 2            |                     | <b>I.Aktivet Afat shkurtra</b>                       | <b>70,216,126</b>   | <b>67,343,822</b>  |
| 3            |                     | <b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>       | 48,448,484          | 41,194,373         |
| 4            | 531                 | Mjete monetare ne Arke                               |                     |                    |
| 5            | 512,56              | Mjete monetare ne Banke                              |                     |                    |
| 6            | 520                 | Disponibilitete ne Thesar                            | 48,448,484          | 41,194,373         |
| 7            | 50                  | Letra me vlere                                       |                     |                    |
| 8            | 532                 | Vlera te tjera                                       |                     |                    |
| 9            | 54                  | Akreditiva dhe paradhenie                            |                     |                    |
| 10           | 59                  | Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)             |                     |                    |
| 13           | 32                  | Inventar I imet                                      | 15,598,784          | 15,327,373         |
| 14           | 33                  | Prodhim nre proces                                   |                     |                    |
| 15           | 34                  | Produkte   |                     |                    |
| 16           | 35                  | Mallra   |                     |                    |
| 17           | 36                  | Kafshe ne rritje e majmeri                           |                     |                    |
| 18           | 37                  | Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve          |                     |                    |
| 19           | 38                  | Diferenca nga cmimet e magazinimit                   |                     |                    |
| 20           | 39                  | Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)           |                     |                    |
| 21           |                     | <b>3.Llogari te Arketushme</b>                       | <b>25,030,734</b>   | <b>5,110,292</b>   |
| 22           | 411                 | Kliente e llogari te ngjashme                        |                     |                    |
| 23           | 423,429             | Personeli, paradhenie, deficite, gjoba               |                     |                    |
| 24           | 431                 | Tatim e Taksa  |                     |                    |
| 25           | 432                 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal         |                     |                    |
| 26           | 433                 | Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti             |                     |                    |
| 27           | 435                 | Sigurime Shoqerore                                   |                     |                    |
| 28           | 436                 | Sigurime Shendetsore                                 |                     |                    |
| 29           | 437,438,            | Organizma te tjere shteterore                        |                     |                    |
| 30           | 44                  | Institucione te tjera publike                        |                     |                    |
| 31           | 465                 | Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere |                     |                    |
| 32           | 468                 | Debitore te ndryshem                                 | 17,983,048          | 129,768            |
| 33           | 4342                | Operacione me shtetin(Te drejta)                     | 7,047,686           | 4,980,524          |
| 34           | 45                  | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike |                     |                    |
| 35           | 49                  | Shuma te parashikuara per xhvlersim(-)               |                     |                    |
| 36           |                     | <b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>                |                     |                    |
| 37           | 409                 | Parapagime   |                     |                    |
| 38           | 473                 | Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin         |                     |                    |
| 39           | 477                 | Diferenca konvertimi aktive                          |                     |                    |
| 40           | 481                 | Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime        |                     |                    |
| 41           | 486                 | Shpenzime te periudhave te ardhshme                  |                     |                    |
| 42           |                     | <b>II.Aktivet Afat gjata</b>                         |                     | <b>265,790,134</b> |
| 43           | 20                  | <b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>               |                     | <b>18,399,892</b>  |
| 44           | 201                 | Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave          |                     |                    |
| 45           | 202                 | Studime dhe kerkime                                  |                     | 18,399,892         |
| 46           | 203                 | Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme             |                     |                    |
| 47           | 21                  | <b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>                  | <b>320,290,974</b>  | <b>247,925,092</b> |
| 48           | 210                 | Toka, T,roje, Terene                                 |                     |                    |
| 49           | 211                 | Pyje, Plantacione                                    | 1,793,836           | 1,793,836          |
| 50           | 212                 | Ndertesa e Konstruksione                             | 43,471,535          | 42,044,173         |
| 51           | 213                 | Rruge, rrjete, vepra ujore                           | 248,305,612         | 193,599,245        |
| 52           | 214                 | Instalime teknike, makineri e paisje                 | 13,682,736          | 4,058,708          |
| 53           | 215                 | Mjete Transporti                                     | 11,916,196          | 6,388,389          |
| 54           | 216                 | Rezerva Shteterore                                   |                     |                    |
| 55           | 217                 | Kafshe pune e prodhimi                               |                     |                    |
| 56           | 218                 | Inventar ekonomik                                    | 1,121,059           | 40,741             |

|    |       |                                      |  |  |
|----|-------|--------------------------------------|--|--|
| 57 | 24    | Aktive afatgjata te demtuara         |  |  |
| 58 | 28    | Caktime te Aktiveve Afatgjata        |  |  |
| 59 | 25-26 | <b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b> |  |  |
| 60 | 25    | Huadhenie e Nenhuadhenie             |  |  |
| 61 | 26    | Pjesmarrje ne kapitalin e vet        |  |  |
| 62 |       | <b>4.Investime</b>                   |  |  |
| 63 | 230   | Per Aktive Afatgjata jo materiale    |  |  |
| 64 | 231   | Per Aktive Afatgjata materiale       |  |  |

## A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 48,448,484 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” të paraqitur më poshtë:

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 48,448,484 gjëndje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

- **Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”** të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 21,039,157 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 21,767,642 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej -728,485 lekë rakordon me gjëndjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,711,784 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,168,858 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 457,074 lekë, e cila përfaqëson shtim të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 15,327,373 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,598,784 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 271,411 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imet per vitin 2022.

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”** paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,110,292 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,030,734 lekë , ku kemi rritje ne vleren 19,920,442 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 129,768 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 17,983,048 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 17,853,280 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 17,853,250 lekë, që zënë 99.3% te vlerës debitore. Pjesa tjetër janë detyrimet te viteve të mëparshme. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në Aneks.

**Konkluzion: Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e

cila nuk rakordon për vlerën 720,898 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit që përbëhet nga shuma e: llog.401-408 “Furnitore e llogari te lidhura me to” në vlerën 1,721,533 lekë, llog.42“Detyrime ndaj personelit” për vlerën 3,328,068 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 136,195 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 1,007,446 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 133,546 lekë dhe llog. “Furnitorë të ndryshëm dhe llogari të lidhura me to” në vlerën 146,181,288 lekë, të cilat janë shumën 152,508,076 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, **pika 32** në të cilën përcaktohet: “*Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjsteve të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”*”.

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

*Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:*

a) *Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).*

b) *Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”;* - *Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

c) *Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.*

d) *Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër: - Debitohet llogaria 476, “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”; - Kreditohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”.*

|  |
|--|
| <b>Titulli gjetjes:</b> Mbi kontabilizimet e gabuara në llog.4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit. |
|--|

**Situata:**

**Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 720,898 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit që përbëhet nga shuma e: llog.401-408 “Furnitore e llogari te lidhura me to” në vlerën 1,721,533 lekë, llog.42“Detyrime ndaj personelit” për vlerën 3,328,068 lekë,

llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 136,195 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 1,007,446 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 133,546 lekë dhe llog. “Furnitorë të ndryshëm dhe llogari të lidhura me to” në vlerën 146,181,288 lekë, të cilat janë shumën 152,508,076 lekë. Ky kontabilizim i gabuar ka sjellë pasaktësi në gjendjen e llogarisë analoge 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në pasqyrën e performancës Formatit 2 i PF të jetë i pasaktë pasi është e barabartë me gjendjen e gabuar të llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”.

**Kriteri:**

Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3, nënpika 8.

**Ndikimi:**

Mosfunksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me evidentimin e saktë të detyrimeve të lindura të konstatuara të shtetit ndaj të tretëve me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me rakordimin aktiv-pasiv të bilancit, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku** Nga Sekori i Financës nuk është kryer saktë kontabilizimi i detyrimeve e lindura të konstatuara ndaj të tretëve.

**Rëndësia:** I lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

Sektori i Financës, Bashkia Pustec në mbyllje të vitit 2023 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara të shtetit/bashkia ndaj të tretëve në llogarinë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”, duke përfshirë detyrimet të gjitha detyrimet për paga, sigurime, tatime ndaj punonjësve dhe detyrimet e lindura ndaj të tretëve për fatura të papaguara në fundvitin ushtrimor të harkut kohor 60 ditë.

**Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :**

- Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

**II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

**Auditimi i aktiveve afatgjata materiale**

*Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale*, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

**2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

### **3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:**

**a.** Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçodon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 247,925,092 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 320,290,974 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 353,731,336 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 430,231,695, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”** që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 18,399,892 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, pasi këto aktive janë shpërndarë sipas aktiveve të kapitalizuar që i përkasin si vlerë e shtuar.

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale”** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 247,925,092 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 320,290,974 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 353,731,336 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 430,231,695 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

**Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,793,836 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,793,836 lekë.

Inventari kontabël i llog. 211 “Pyje, Plantacione”

| Nr | Emërtimii I aktiveve                                      | Gjendja me 31.12.2021 | Shtesa gjate vitit 2022 | Gjendja më 31.12.2022 |
|----|---|-----------------------|-------------------------|-----------------------|
| 1  | Punim gjelberim sistem i teritoreve publike Komuna Pustec | 1,793,836             | 0                       | 1,793,836             |

|                |        |           |   |           |
|----------------|--------|-----------|---|-----------|
| BASHKIA PUSTEC | TOTALI | 1,793,836 | 0 | 1,793,836 |
|----------------|--------|-----------|---|-----------|

- **Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 42,044,173 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 543,471,535lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 50,552,353 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 54,715,489 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 4,163,136 lekë, ku vlera prej 3,958,816 lekë nga rritja e AAGJM me pagesë si: rikonstruksion muze historik shtese (levizja brenda aktiveve) qe perfaqeson shperndarja e llog. 202 “Studime dhe kerkime”, me vlerën 204,320 lekë Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

**Inventari kontabël i llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”**

| Nr. | Pershkrimi i aktivitet                                     | Vlera dt.01.01.2021 |                   | Hyrje viti 2022  | Vlera dt. 31.12.2022 |                   |
|-----|--|---------------------|-------------------|------------------|----------------------|-------------------|
|     |  |                     |                   |                  |                      |                   |
| 1   | Spitali Liqenas (Q.Shendetesore)                           | 1777200             | 1777200           |                  | 1777200              | 1,777,200         |
| 2   | Shkolla e mesme Liqenas                                    | 24276443            | 24276443          | 159,200          | 961791               | 24,435,643        |
| 3   | Shkolla fillore Diellas                                    | 3282078             | 3282078           |                  | 2597648              | 3,282,078         |
| 4   | Shkolla fillore Liqenas                                    | 762348              | 762348            |                  | 56600                | 762,348           |
| 5   | Shkolla fillore Zaroshke                                   | 3698796             | 3698796           |                  | 3548657              | 3,698,796         |
| 6   | Shkolla fillore Cerje                                      | 24000               | 24000             |                  | 24000                | 24,000            |
| 7   | Shkolla fillore G. Vogel                                   | 173770              | 173770            |                  | 54000                | 173,770           |
| 8   | Shkolla fillore G. Madhe                                   | 4285662             | 4285662           |                  | 4040662              | 4,285,662         |
| 9   | Shkolla fillore Kallamas                                   | 3189232             | 3189232           | 12,000           | 196589               | 3,201,232         |
| 10  | Shkolla fillore Gollomboc                                  | 339161              | 339161            |                  | 339161               | 339,161           |
| 11  | Baza prodh. Liqenas  | 26969               | 26969             |                  | 26969                | 26,969            |
| 12  | Qen . Shend G. Vogel                                       | 12000               | 12000             |                  | 12000                | 12,000            |
| 13  | Garazhe makine Liqenas                                     | 200000              | 200000            |                  | 200000               | 200,000           |
| 14  | Zyrat e komunes  | 6695340             | 6695340           | 25,320           | 6330988              | 6,720,660         |
| 15  | Kabina elektrike Gollomboc                                 | 60000               | 60000             |                  | 60000                | 60,000            |
| 16  | Ndrt. Muri cezma Liqenas                                   | 82900               | 82900             |                  | 82900                | 82,900            |
| 17  | Sist sheshi fshati Gollomboc                               | 190000              | 190000            |                  | 190000               | 190,000           |
| 18  | Ndertim trotuari Pustec                                    | 861600              | 861600            | 7,800            | 861600               | 869,400           |
| 19  | Sistemim vend. tub. G. Vogel                               | 145000              | 145000            |                  | 145000               | 145,000           |
| 20  | Gazebo druri   | 469854              | 469854            |                  | 469854               | 469,854           |
| 21  | Muzeum Sterio Spase Pages Tvsh+Bashkefinanc project I huaj |                     |                   | 3,958,816        | 3958816              | 3,958,816         |
|     | <b>Totali</b>  |                     | <b>50,552,353</b> | <b>4,163,136</b> |                      | <b>54,715,489</b> |

- **Gjendja e llogarisë 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 193,599,245 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në 248,305,612 lekë, ku diferenca prej 54,706 lekë është amortizimi i llogariturpër vitin 2022. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 231,600,561 leke dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 301,375,713 leke. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 69,775,152 lekë, e përbërë nga vlera 51,579,580 lekë përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në rehabilitim kanali dhe vlera prej18,195,572 lekë nga sistemimi i llog 202 “studime dhe kerkime”. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

**Inventari kontabël i llog. 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”**

| Nr. | Pershkrimi i aktivitet                                   | Vlera dt.01.01.2022 |          | Hyrje viti 2022 në lekë | Vlera dt.31.12.2022 në lekë |
|-----|--|---------------------|----------|-------------------------|-----------------------------|
|     |  | Në lekë             |          |                         |                             |
| 1   | Sistemim + asfaltim rruge fshati Liqenas                 | 43668347            | 43668347 | 596,713                 | 44,265,060                  |
| 2   | Ndertim fushe sporti Liqenas                             | 943738              | 943738   |                         | 943,738                     |
| 3   | Rikonstruksion rruge fshati Zaroshke                     | 658700              | 658700   |                         | 658,700                     |
| 4   | Rikonstruksion sistemim+ asfaltim Rruge fshati Gollomboc | 21438604            | 21438604 | 260,000                 | 21,698,604                  |
| 5   | Pastrim kanale te II -III Bashkia Pustec                 | 931689              | 931689   | 27,000                  | 958,689                     |
| 6   | Rikon,sistemim rruge fshati Diellas                      | 9210319             | 9210319  | 170,000                 | 9,380,319                   |
| 7   | Sistemim + asf rruga Gorice e vogel(Dollna Gorica)       | 5279837             | 5279837  | 154,800                 | 5,434,637                   |
| 8   | Ndertim fushe sporti Gorice e vogel                      | 199657              | 199657   |                         | 199,657                     |
| 9   | Rikon + asfaltim rruge fshati Kallamas (Tuminec)         | 21806033            | 21806033 | 450,000                 | 22,256,033                  |
| 10  | Rikons rruge fshati Lajthize                             | 821940              | 821940   |                         | 821,940                     |
| 11  | Sistemim rruge fshati Cerje                              | 732963              | 732963   |                         | 732,963                     |
| 12  | Sistemim lere fshati Cerje                               | 299620              | 299620   |                         | 299,620                     |

|    |   |           |                    |                   |                    |
|----|---|-----------|--------------------|-------------------|--------------------|
| 13 | Sistem asf rruge fshati Gorice e madhe    | 17409916  | 17409916           |                   | 17,409,916         |
| 14 | Furnizime me uje I pijshem Bashkia Pustec | 108199198 | 108199198          | 51,474,459        | 159,673,657        |
| 15 | Ujesjellsi fshati Kallamas                |           |                    | 290,400           | 290,400            |
| 16 | Ujesjellsi fshati Gollomboc               |           |                    | 265,000           | 265,000            |
| 17 | Ujesjellsi fshati Shulin (Diellas)        |           |                    | 7,200             | 7,200              |
| 18 | Rehabilitim kanali fshati Pustec          |           |                    | 16,079,580        | 16079580           |
|    | <b>Totali</b>                             |           | <b>231,600,561</b> | <b>69,775,152</b> | <b>301,375,713</b> |

- **Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,058,708 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,682,736 lekë, ku diferenca është amortizimi i perlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grupaktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,527,462leke dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,119,584 leke. Në këtë grupaktivesh ka shtesa për vitin 2022 me vlerë prej 10,592,122 leke, ku shtesa prej 1,408,648 perfaqeson blerje te kryer me pagese brenda sistemit paisje per sektorin e mzsh-se dhe vlera prej 9,183,474 leke shtese brenda sistemit. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqitet në Aneks.

**Inventari kontabël i llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"**

| Nr. | Pershkrimi i aktivitet                             | Vlera dt.01.01.2022 | Hyrje viti 2022   | Vlera dt.31.12.2022 |
|-----|--|---------------------|-------------------|---------------------|
| 1   | Pajisje elektrike neone Ligenas                    | 485,481.0           |                   | 485,481             |
| 2   | Pajisje elektrike neper fshatra                    | 1,243,064.0         |                   | 1,243,064           |
| 3   | Lidhje internet                                    | 202,800.0           |                   | 202,800             |
| 4   | Gjenerator   | 119,000.0           |                   | 119,000             |
| 5   | Pajisje zyre (stabilizator 1)                      | 25,000.0            |                   | 25,000              |
| 6   | Blerje pore zjari                                  | 70,000.0            |                   | 70,000              |
| 7   | Vendosje neone Pustec                              | 440,000.0           |                   | 440,000             |
| 8   | Vendosje neone Pustec                              | 466,200.0           |                   | 466,200             |
| 9   | Pajisje elektrike                                  | 147,650.0           |                   | 147,650             |
| 10  | Furnizim +vendosje sahat uji                       | 1,709,906.0         |                   | 1,709,906           |
| 11  | Mbik punimi sahat uji                              | 41,038.0            |                   | 41,038              |
| 12  | Kolaudator   | 6,412.0             |                   | 6,412               |
| 13  | Tabele informuese                                  | 1,973,213.0         |                   | 1,973,213           |
| 14  | Tabele informuese                                  | 394,642.0           |                   | 394,642             |
| 15  | Ndertim shkalle                                    | 451,724.0           | 90,335            | 542,059             |
| 16  | Blerje Photo                                       | 453,732.0           |                   | 453,732             |
| 17  | Blerje uniforma PMNZSH                             | 297,600.0           |                   | 297,600             |
| 18  | Pompe Dranazhi Heron                               |                     | 223,660.01        | 223,660             |
| 19  | Kit fotovoltaiik ndricim rrugor(ndricim I jashtem) |                     | 4,925,880.00      | 4,925,880           |
| 20  | Kit fotovoltaiik ndricim rrugor(ndricim I jashtem) |                     | 2,686,843.00      | 2,686,843           |
| 21  | Kostume zhytjeje                                   |                     | 1,406,520         | 1,406,520           |
| 22  | Pagese tvsh-Net metering                           |                     | 1,258,884.00      | 1,258,884           |
|     | <b>TOTALI</b>                                      | <b>8,527,462</b>    | <b>10,592,122</b> | <b>19,119,584</b>   |

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,388,389 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,916,196 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 37,508,730 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 45,301,618 lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 përfaqësojnë blerjen e mjeteve me vlerë 11,276,388 lekë dhe pakesime me vlerën 3,483,500 lekë për automjetet e Bashkisë Pustec . Analiza e gjendjes së kësaj llogarije dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks:

**Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022**

|   | BASHKIA PUSTEC llog.215 | Gjendja me 31.12.2021 | Shtesa Viti 2022 | Pakesime Viti 2022 | Gjendja me 31.12.2022 |
|---|-------------------------|-----------------------|------------------|--------------------|-----------------------|
| 1 | Makine Suzuki K00138Z   | 670000                |                  | 670000             |                       |
| 2 | Makine toyota K04443B   | 1900000               |                  | 1900000            |                       |
| 3 | Ambulance               | 992250                |                  |                    | 992250                |
| 4 | Xhip Nissan K04673B     | 913500                |                  | 913500             |                       |

|    |   |                   |                   |                  |                   |
|----|---|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| 5  | Anije solare  | 19876000          |                   |                  | 19876000          |
| 6  | Blerje automjeti sharon AA800CM(Sharoni I Bashkise) | 840000            |                   |                  | 840000            |
| 7  | Blerje fadrome ADMT-63 (fadroma e bashkise)         | 3000000           |                   |                  | 3000000           |
| 8  | Xhip Duster AB188AC (xhipi I bashkise)              | 2257528           |                   |                  | 2257528           |
| 9  | Ambulance Volcvagen AB185DL                         | 2166500           |                   |                  | 2166500           |
| 10 | Zjarfikse Daimler AB212BL(PMNZSH)                   | 3810019           |                   |                  | 3810019           |
| 11 | Kamioncine Benz AB142DL(Aut.i mb.te.ng.Z.Pustec)    | 1082933           |                   |                  | 1082933           |
| 12 | Makine Suzuki K00138Z                               | 670000.00         |                   |                  | 670000.00         |
| 13 | Eskavator me goma TG ABMT79                         |                   | 4,668,000         |                  | 4,668,000         |
| 14 | Varke me ajer+motor                                 |                   | 2,672,388         |                  | 2,672,388         |
| 15 | Toyota Tg AB527HI MZSH                              |                   | 3,936,000         |                  | 3,936,000         |
|    | <b>TOTALI</b>                                       | <b>37,508,730</b> | <b>11,276,388</b> | <b>3,483,500</b> | <b>45,301,618</b> |

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 40,741 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,121,059 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)”gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,348,502 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 7,975,455 lekë,shtesa gjate vitit 2022 eshte 2,626,952 leke ku vlera porej 268,680 leke jane inventare ekonomik per sektorin e MZSH, dhe vlera prej 2,358,273 leke levizje brenda sistemit, inventar ekonomik i muzeumit.

**Konkluzion:** Gjendja e **llog. 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontratë që ka përfunduar si punime, por likujdimi është shtrirë në mbi 2-3 vite ushtrimore, për të cilën janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likujdimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogarja 231“Shpenzime për investime në proces” nuk është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke i kaluar pagesat në mënyrë të gabuar në llogarinë e aktivitetit pa u kapitalizuar aktiviteti deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2022 konstatohet se ka:

- 1 kontratë projekt investimi me objekt: “Furnizim me ujë, Bashkia Pustec (ndërtim Ujsjells i rrjeti)” në vlerë kontrate punimesh dhe mbikqyrje prej 545,123,873 lekë, kontratë i cila ka mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 401,424,675 lekë, dhe vlera pjesore e paguar prej 143,699,198 lekë.

- 1 kontratë projekt investimi me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Pustec” në vlerë kontrate punimesh dhe mbikqyrje prej 25,475,580 lekë, kontratë i cila ka mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 9,396,000 lekë, dhe vlera pjesore e paguar prej 16,079,580 lekë.

Vlera pjesore e paguar prej 159,504,255 lekë për të dy kontratat e investimit duhet t’i përkiste gjendjes debitore llog. 231“Shpenzime për investime në proces” me datë 31.12.2022 dhe jo gjendjes së llogarisë 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 23<sup>3</sup>, si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

<sup>3</sup>- Për rrjedhim, aktivitet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, "Investime". - Këto janë investime në proces, pra aktivitet ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, "Investime" ndahet në dy llogari treshifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatëshifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.

- Llogaria 231, "Investime për aktive afatgjata materiale", të analizuar në llogari shtatëshifrore.

Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.



**Titulli gjetjes:** Mbi kontabilizimet e gabuara në llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”

**Situata:**

Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likujdimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogarja 231“Shpenzime për investime në proces” nuk është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke i kaluar pagesat në mënyrë të gabuar në llogarinë e aktivit, pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2022 konstatohet se 2 kontrata investimesh në vlerë të plotë 570,599,453 kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 410,820,675 lekë, dhe vlera pjesore e paguar prej 159,504,255 lekë duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231“Shpenzime për investime në proces” me datë 31.12.2022 dhe jo gjendjes së llogarisë 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

**Kriteri:**

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

**Impakti:**

Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i AAGJM të blera deri në kapitalizmin e tyre.

**Shkaku:**

Sektori i Financës ka bërë kontabilizimin direkt në llogarinë AAGJM me vlera pjesore të paguara, ndërkohë kur aktivi nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë të kontratës, pa e kontabilizuar në llog. e ndërmjetme llog. 231“Shpenzime për investime në proces” deri në momentin e kapitalizimit.

**Rëndësia:** I mesme

**Për këtë rekomandojmë:**

Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë. Pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

| Nr. Refere Llogari | EMERTIMI                          | Teprica ne fillim |                |              | Shtesat gjate vitit |            | Paksimet gjate vitit | Teprica ne Fund |                |              |
|--------------------|-----------------------------------|-------------------|----------------|--------------|---------------------|------------|----------------------|-----------------|----------------|--------------|
|                    |                                   | Kosto Historike   | Amortiz Akumul | Teprica Neto | Kosto Historike     | Amortiz    | Kosto Historike      | Kosto Historike | Amortiz Akumul | Teprica Neto |
| b                  | c                                 | 1                 | 2              | 3            | 4                   | 5          | 6                    | 8               | 9              | 10           |
| 20                 | I. AAGJ/JO MATERIALE              | 18,399,892        | 0              | 18,399,892   |                     |            | 18,399,892           | 0               |                | 0            |
| 202                | Studime dhe kerkime               | 18,399,892        | 0              | 18,399,892   |                     |            | 18,399,892           | 0               |                | 0            |
| 21- 28             | II. AAGJ/ MATERIALE               | 335,331,444       | 87,406,352     | 247,925,092  | 98,433,751          | 22,584,369 | 3,483,500            | 430,281,695     | 109,990,721    | 320,290,974  |
| 210                | Toka,troje,Terene                 | 0                 | 0              | 0            |                     |            |                      |                 |                |              |
| 211                | Pyje,Kullota Plantacione          | 1,793,836         | 0              | 1,793,836    |                     |            |                      | 1,793,836       | 0              | 1,793,836    |
| 212                | Ndertime e Konstruksione          | 50,552,353        | 8,508,180      | 42,044,173   | 4,163,136           | 2735774    |                      | 54,715,489      | 11,243,954     | 43,471,535   |
| 213                | Rruge,rrjete,vepra ujore          | 231,600,561       | 38,001,316     | 193,599,245  | 69,775,152          | 15068785   |                      | 301,375,713     | 53,070,101     | 248,305,612  |
| 214                | Instal tekn,makin,paisje,vegla pu | 8,527,462         | 4,468,754      | 4,058,708    | 10,592,122          | 968094     |                      | 19,119,584      | 5,436,848      | 13,682,736   |

|                     |                                   |                    |                   |                    |                   |                   |                   |                    |                    |                    |
|---------------------|-----------------------------------|--------------------|-------------------|--------------------|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| 215                 | Mjete transporti                  | 37,508,730         | 31,120,341        | 6,388,389          | 11,276,388        | 2265081           | 3,483,500         | 45,301,618         | 33,385,422         | 11,916,196         |
| 216                 | Rezerva shtetore                  | 0                  | 0                 | 0                  |                   |                   |                   | 0                  | 0                  | 0                  |
| 217                 | Kafshe pune e prodhimi            | 0                  | 0                 | 0                  |                   |                   |                   | 0                  | 0                  | 0                  |
| 218                 | Inventar ekonomik                 | 5,348,502          | 5,307,761         | 40,741             | 2,626,953         | 1546635           |                   | 7,975,455          | 6,854,396          | 1,121,059          |
| 24                  | Aktive te Q.te trupez te demtuara | 0                  | 0                 | 0                  |                   |                   |                   |                    |                    |                    |
| 28                  | Caktime                           | 0                  | 0                 | 0                  |                   |                   |                   |                    |                    |                    |
| <b>TOTALI(I+II)</b> |                                   | <b>353,731,336</b> | <b>87,406,352</b> | <b>266,324,984</b> | <b>98,433,751</b> | <b>22,584,369</b> | <b>21,883,392</b> | <b>430,281,695</b> | <b>109,990,721</b> | <b>320,290,974</b> |

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 109,990,721 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

**Konkluzion:** Nga verifikimi i përllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur aktiv për aktiv, për llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”, llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe llog.215 “Mjete transporti” në masën 5%, për llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në masën 20% duke respektuar normat ligjore të miratuara. Ndërsa në rastin e përllogaritjes së aktiveve të llog. 218 “Inventar Ekonomik” është përllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 10% dhe jo 20% sa është norma e amortizimit e miratuar dhe për artikullin “kompjuter” në masën 25% sic i takon këtij grupaktivesh. Kjo ka ndodhur për arsye se, ulet vlera e aktiveve në minimum dhe nuk mund të bëhëj rivlerësim i këtyre aktiveve. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

**Titulli gjetjes:** Mbi përllogaritjen e gabuar dhe evidentimin e pasaktë të vlerës së amortizimit në kontabilitet për grupaktivet e llog. 218 “Inventar Ekonomik”

**Situata:**

Nga verifikimi i përllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur aktiv për aktiv, për llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”, llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe llog.215 “Mjete transporti” në masën 5%, për llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në masën 20% duke respektuar normat ligjore të miratuara. Ndërsa në rastin e përllogaritjes së aktiveve të llog. 218 “Inventar Ekonomik” është përllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 10% dhe jo 20% sa është norma e amortizimit e miratuar dhe për artikullin “kompjuter” në masën 25% sic i takon këtij grupaktivesh.

**Kriteri:**

Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 36.

**Ndikimi:**

Evidentimi i vlerave të gabuara në kontabilitet për amortizimin e aktiveve të llog. 218 “Inventar Ekonomik”

**Shkaku**

Nga Sektori i Financës nuk është kryer përllogaritja e saktë e amortizimit sipas normave ligjore për aktivet e llog. 218 “Inventar ekonomik”.

**Rëndësia: I lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Sektori i Financës, Bashkia Pustec të llogarisë në mënyrë të saktë amortizimin e aktiveve të llog.218 “Inventar ekonomik” sipas normave ligjore dhe të kryejë veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse. Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023 të ketë në konsideratë veprimet rregullta në llogaritjen e amortizimit vjetor si dhe të reflektojë

ndryshimet si rrjedhojë e korigjimeve të këryera për efekt të mbylljes së vitit ushtrimor 2022.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Pustec**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Pustec.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022 kane dalë urdheri me nr.156, dates 01.09.2022 “Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit dhe azgjesimin për vitin 2022”. Janë mbajtur procesverbale nga cdo komision. Eshte mbajtur relacion shpjegues për gjendjen e llogarive”si dhe procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë humbur funksionin e tyre. Të gjitha proceset e kryerjes së inventareve për vitet 2022 janë me dokumentacion bashkëlidhur. Sipas këtij inventarizimi nuk janë nxjerre aktive afatgjata jashtë përdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive për Bashkinë Pustec. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit shtator 2022 dhe rezultojnë pa diferenca.

Në rubrikën e e rezultati/shënime nga komisionet e inventarizimit janë evidentuar aktivitet që propozohen për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të inventarizimit nga grupi i inventarizimit është hartuar raporti përmbledhës i datës 01.09.2022 për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Nga komisioni i inventarizimit është hartuar procesverbali i vlerësim-asgjesimit datë 27.09.2022 të inventarit të imët. Në këtë dokument janë listuar artikujt e aktiveve të llog. 32 “inventar i imët” në vlerën prej 48,275 lekë dhe në fund komisioni është shprehur se këto aktive janë të konsumuara e nuk kanë më vlerë përdorimi dhe nuk mund të riparohen, pastaj janë kryer procedurat e asgjesimit.

Për 3 automjete jashtë funksioni janë kryer procedurat e vlerësimit të nxjerrjes jashtë përdorimi në vlerën 3,483,500 lekë, për të cilat është bërë miratimi me VKB nr. 18 datë 29.04.2022. Kjo procedurë fillon me Urdhrrin e Titullarit nr 83 datë 03.06.2021 për ngritjen komisionit të vlerësimit gendjes teknike të mjeteve të Bashkisë me 5 anëtarë , ku 2 janë inxhinierë mekanik si specialitë të fushës. Nga komisioni i vlerësimit është mbajtur procesverbali i datës 17.06.2021 i cili shprehet dhe argumenton arsyet e vlerësimit të 3 automjeteve jashtë përdorimi të shoqëruar me aktin tekniko-finaciar me datë 17.06.2021 dhe fotot përkatëse. Ka dalë Urdhri i Titullarit nr.117 datë 06.06.2022 për ngritjen e grupit të punës për çmontimin e mjeteve të destinuara për skrap të përbërë nga 3 anëtarë. Skrapi i rezultuar është bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr.30 datë 04.07.2022 në vlerën 71,680 lekë në bazë të procesverbalit të grupit të punës së çmontimit nga ku rezultoi skrap me përbërëje: 8kg bakër, 32 kg alumin dhe 3200 kg hekur dhe materiale për asgjesim kallçuk/gomë/qelq 400kg. Me urdhër nr.128 datë 06.07 2022 është ngritur komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë prej 3 anëtarësh: V. S, D. S dhe M. J. Mbi bazën e procesverbalit nr.prot. 979/2 datë 07.07.2022 nga komisioni është përlllogaritur fondi limit i cili është përcaktuar mbi bazën e 3 ofertave të marra nga 3 operatorë ekonomikë të paraqitur në procesverbalin nr.prot.979/4 datë 08.07.2022 si: OE “E”shpk me vlerë 71.680 lekë, OE “S. R.” me vlerë 69,600 lekë dhe OE “XH.F. K.(E. L.)”

me vlerë 69,520 lekë. Komisioni i prokurimit ka vlerësuar si më të leverdisshme ofertën më të lartë OE “E”shpk me vlerë 71.680 lekë. Kjo procedurë është zhvilluar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “për prokurimin publik dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik neni 76, pika 1 gërma (b) “për llogaritjen e vlerësimit dhe neni 56 “mbi përdorimin e procedurë së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

**Analiza e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:**

në lekë

| Nr.Reshti | Referenca e Llogarive | EMERTIMI   | Ushtrimi I Mbyllur 2022 | Ushtrimi Paraardhes 2021 |
|-----------|-----------------------|--|-------------------------|--------------------------|
| 65        | <b>B</b>              | <b>PASIVET(DETYRIMET)</b>                            | <b>161,672,540</b>      | <b>12,698,558</b>        |
| 66        |                       | <b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>                       | <b>161,672,540</b>      | <b>12,698,558</b>        |
| 67        |                       | <b>1. Llogari te Pagushme</b>                        | <b>161,672,540</b>      | <b>12,698,558</b>        |
| 68        | 401-408               | Furnitore e llogari te lidhura me to                 | 1,721,533               | 2,179,094                |
| 69        | 42                    | Detyrime ndaj personelit                             | 3,328,068               | 2,804,280                |
| 70        | 16,17,18              | Hua Afat shkurtra                                    |                         |                          |
| 71        | 460                   | Huadhenes  |                         |                          |
| 72        | 431                   | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa                | 136,195                 | 136,115                  |
| 73        | 432                   | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal         |                         |                          |
| 74        | 433                   | Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore                  |                         |                          |
| 75        | 435                   | Sigurime Shoqerore                                   | 1,007,446               | 887,203                  |
| 76        | 436                   | Sigurime Shendetsore                                 | 133,546                 | 117,613                  |
| 77        | 437,438,              | Organizma te tjere shteterore                        |                         |                          |
| 78        | 44                    | Institucione te tjera publike                        |                         |                          |
| 79        | 45                    | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike |                         |                          |
| 80        | 464                   | Det.per tu paguar per bl.etrave me vlere             |                         |                          |
| 81        | 466                   | Kreditore per mjete ne ruajtje                       | 9,134,596               | 6,383,817                |
| 82        | 467                   | Kreditore te ndryshem                                | 146,181,288             | 160,568                  |
| 83        | 4341                  | Operacione me shtetin( detyrime                      | 29,868                  | 29,868                   |
| 84        | 49                    | Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)              |                         |                          |
| 85        |                       | <b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>                |                         | <b>0</b>                 |
| 86        | 419                   | Kreditore, Parapagime                                |                         |                          |
| 87        | 475                   | Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese      |                         |                          |
| 88        | 478                   | Diferenca konvertimi pasive                          |                         |                          |
| 89        | 480                   | Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar         |                         |                          |
| 90        | 487                   | Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit  |                         |                          |
| 91        |                       | <b>II.Pasivet Afat Gjata</b>                         |                         | <b>0</b>                 |
| 92        | Klase 4               | Llogari te pagushme                                  |                         |                          |
| 93        | 16.17,18              | Huate Afat gjata                                     |                         |                          |
| 94        |                       | Provizionet afatgjata                                |                         |                          |
| 95        | Klasa 4               | Te tjera   |                         |                          |
| 96        | <b>C</b>              | <b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>                    | <b>415,537,834</b>      | <b>321,970,883</b>       |
| 97        | <b>D</b>              | <b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>                         | <b>415,537,834</b>      | <b>321,970,883</b>       |
| 98        | 101                   | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar      | 375,495,460             | 274,890,342              |
| 99        | 12                    | Rezultatet e mbartura                                |                         |                          |
| 100       | 85                    | Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore                  | 40,042,374              | 47,080,541               |
| 101       | 111                   | Rezerva  |                         | 0                        |
| 102       | 115                   | Nga Fondet e veta te investimeve                     |                         | 0                        |
|           | 15                    | Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime      |                         | 0                        |
| 103       | 105                   | Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne            |                         | 0                        |
| 104       | 106                   | Teprica e Granteve kapitale Te Huaja                 |                         | 0                        |
| 105       | 107                   | Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim             |                         | 0                        |
| 106       | 109                   | Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata          |                         | 0                        |
| 107       |                       | Te Tjera   |                         | 0                        |
| 108       | <b>E</b>              | <b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>                        | <b>577,210,374</b>      | <b>334,669,441</b>       |

**Pasivet afatshkurtra.** Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 161,672,540 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,179,094 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,721,533, vlerë e cila ka ardhur në ulje, për faktin e likuidimit të disa faturave të vitit të mëparshëm. Sipas analizës së gjëndjes së kësaj llogarie rezultoi se, përbëhet nga 24 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar gjatë vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

**Analiza e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**

| NR | PERSHKRIMI   | NR          | DATE       | Vlera e pa likujduar |
|----|--|-------------|------------|----------------------|
| 1  | Perpilim akti  | fat 07/2021 |            | 25,000               |
| 2  | Vendim Gjyqesor                                      | 54/2021     |            | 377,800              |
| 3  | Sherbime postare                                     | 633         | 31.10.2020 | 2,410                |
| 4  | Sherbime postare                                     | 660         | 31.10.2020 | 10,178               |
| 5  | Pagese tvsh-je                                       | 19          | 24.09.2020 | 24,265               |
| 6  | Sherbime të tjera                                    | 1166        | 18.09.2017 | 52,500               |
| 7  | Sherbime postare                                     | 1174        | 31.12.2019 | 735                  |
| 8  | Sherbime postare                                     | 1191        | 31.12.2019 | 3,120                |
| 9  | Sherbime avokatore                                   | 5           | 03.04.2019 | 48,000               |
| 10 | Organizim ëëbinari                                   | 388         | 31.08.2021 | 579,690              |
| 11 | Sherbim uji ipijshëm                                 | fat 01/2021 |            | 29,100               |
| 12 | Sherbime postare                                     | 10 fat 2021 |            | 76,169               |
| 22 | vendime gjyqesore                                    | fat 05/2021 |            | 15,000               |
| 23 | Pagese kolauditori                                   | 15/2021     |            | 20,005               |
|    | pagese tvsh-je                                       | 47          | 12/10/2020 | 457,561              |
|    | <b>T O T A L I I L L O G A R I S E 4 0 1 - 4 0 4</b> |             |            | <b>1,721,533</b>     |

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 3,328,068 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguheshin në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 136,195 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguheshin në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 1,007,446 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 133,546 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 66,773 lekë

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 66,773 lekë.

**Konkluzion:** **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin ( detyrime)”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë. vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari, që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që të tretët i kanë shtetit/bashkisë për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3.

**Titulli gjetjes:** Mbi kontabilizimet në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”

### **Situata:**

**Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë. vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari, që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që të tretët i kanë shtetit/bashkisë për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë.

### **Kriteri:**

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3<sup>4</sup>.

### **Impakti:**

Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i detyrimeve ndaj shtetit/bashkisë.

### **Shkaku:**

Sektor i Financës ka bërë kontabilizim të gabuar të detyrimeve ndaj shtetit/bashkisë.

### **Rëndësia: I lartë**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Sektor i Financës në Bashkinë Pustec në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit/bashkisë si debitorët, duke i evidentuar në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,134,596 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se gjendja në bilanc rakordon me analizën e llogarisë sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit. Analiza e llog 466 sipabërë rakordimi në degën e Thesarit Korçë paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 160,568 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 146,181,288 lekë me një diferencë në rritje prej 146,020,720 lekë në krahasim me vitin 2021, vlerë e cila i takon faturave të papaguara të investimit me objekt: “Furnizim me ujë Bashkia Pustec” gjatë vitit 2022. Ndërsa pjesa tjetër në vlerën 72,494 lekë i takon detyrimeve që ka Bashkia ndaj 47 individëve për ndihmë ekonomike detyrime të krijuara që nga vitet 1998 dhe vlera prej 88074 lekë e emërtuar të tjera e paanalizuar dhe nuk dihet se çfarë detyrimesh janë. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në Aneks:

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneks.

---

<sup>4</sup>Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 122,734,924 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Tepelenë paraqitet më poshtë:

**Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 4,484,317 lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 0 lekë, ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,459,047 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,025,270 leke e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndricimit, zënie hapësire publike, qirate për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 1,811,758 lekë, i cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 330,355 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 1,481,403 leke, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** është në vlerën prej 7,047,686 leke, e cila rakordon me gjendjen e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin (Te drejta)”**.

**Analiza e shpenzimeve** në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 83,421,037 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 44,325,913 leke dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 44,325,913 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 7,413,100 leke dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 7,413,100 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 13,335,249 lekë dhe sipa aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 13,335,249 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,71,408 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 1,701,408 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 17,373,852 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

**Per vitin 2022** totali i te ardhurave ne vlere eshte 122,734,924 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 83,421,037 lek . Diferenca e tyre ne vleren 39,313,888 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -728,485 lekë .

#### **Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”**

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 98,433,751 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 65,819,724 lekë fonde të akorduara per investime,vlera prej 32,614,027 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas.

- Zëri **“Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale”** formati 6 e plotësuar për shumën **65,819,724** lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore,gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 gerrat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z.C. N. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

***Shpjegime për observacionin e bërë nga Bashkia Pustec me shkresën përcjellëse nr.prot 116, datë 25.01.2024 në lidhje me këtë pikë sqarojmë:***



***Pretendimi i subjektit:*** Për të gjitha kontabilizimet e gabuara të konstatuara do të merren në konsideratë për të saktësuar në kontabilizimet e kryera në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të këtij viti.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:*** Përsa i përket këtij observacioni, sqarojmë se konfirmohen të gjitha konstatimet e grupit të KLSH, duke i bërë këto shpjegime të karakterit justifikues dhe në mungesë të argumentit ligjor. Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë.

### **III. 2.3.4. Mbi administrimin e asetëve procedurave të inventarizimit dhe rregjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i veprimtarisë dhe të dhënave në lidhje me procedurat e inventarizimit dhe rregjistrimit të asetëve rezultoi se Sektori i Menaxhimit të Asetëve mungon. Gjithashtu mungojnë kthim-përgjigjet nga korespondenca me ASHK dhe AZM.

- Bashkia Pustec nuk ka krijuar Sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Asetëve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej prej 438.4 ha, ku 31.8 ha pyll dhe 240 ha kullota, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Bashkia Pustec ka vazhduar punën sipas Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec dhe me Urdhrin nr. 149 prot, datë 27.09.2021 është bërë zëvendësimi i një anëtarit të larguar. Deri në momentin e auditimit, grupi i punës nuk ka përfunduar punën për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”,

- Me VKM nr.103, datë 3.2.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Liqenas të qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit të pronave me 29 fletë dhe përfundon me numër rendor 148. Numri rendorë 1-10, prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, 11-20 prona që përfaqësojnë terrene sportive, vatër kulture dhe lapidare, 21-29 prona që përfaqësojnë troje pra infrastrukturë vendore, 30-38 shërbim funeral, 81-97 prona që përfaqësojnë infrastrukturë rrugore, 98-122 prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive), 123-137 prona që përdoren në fushën e mbrojtjes dhe 138-148 prona që janë të fushës së shëndetësisë. Me miratimin e reformës territoriale për këtë Bashki janë miratuar me VKM nr 48, datë 26.01.2022 listat përfundimtare të transferuara Bashkisë Pustec

në janar të vitit 2022 me objekt: “*Transferimi, në pronësi të Bashkisë Pustec, për Njësinë Administrative Pustec, të disa pasurive me vendndodhje në zonat kadastrale 2462 dhe 1797*”.

- Nga ana e Bashkisë Pustec janë mbajtur vazhdimisht korespondenca me ASHK për identifikimin dhe transferimin e pronave, por që zvarriten pjesërisht nga mungesa e informacionit pjesërisht nga ngarkesat në punë të zyrave të ASHK. Bashkia Pustec në aplikimet në ASHK ka ndjekur një procedure si më poshtë:

Me shkresën nr.prot.1411, datë 31.10.2023 “Kërkesë për të kryer procedure të transferimit për 12 prona të bashkisë Pustec” është bashkëlidhur ky dokumentacion:

1. VKB nr.10, datë 24.02.2022 "Per miratimin e listës shtesë të 4 pronave në fushën e infrastruktures vendore, e konfirmuar nga institucionit i Prefektit.

2.VKM nr.40, datë 24.08.2022 "Per miratimin e listes shtese te 22 pronave te bashkise , ne fushen Bujqesi dhe ushqim e konfirmuar nga institucionit i Prefektit

3. Harta treguese + kartelat e 12 ( dymbedhjetë) pasurive

4. Planet e rievimit per 12 pasurite, simbas formatit te kerkuar,

5. Formati elektronik 2 CD (sipas fushes te perdorimit, 1 në fushën e infrastrukturës vendore, 4 pasuri, 1 në fushën e bujqesisë dhe në fushën e ushqimit 8 pasuri) janë dërguar me shkresën nr.prot.1499, datë 09.11.2022.

- Edhe pse ka përpjeke të vazhdueshme nga Bashkia Pustec për identifikimin, inventarizimin dhe rregjistrimin e këtyre pronave, përseri pjesa dërmuese e tyre mbetet në faza fillestare, kryesisht për mungesa fondesh. Gjithashtu për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

- Për këto prona nuk janë lidhur kontrata qiraje në referencë të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, toka të pafrytshme me sipërfaqe gjithsej 706 ha.

|   |
|---|
| <b>Titulli gjetjes:</b> Mos përfundim i procesit të identifikimit e rregjistrimit të proanave |
|---|

**Situata:**

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i veprimtarisë dhe të dhënat në lidhje me procedurat e inventarizimit dhe rregjistrimit të aseteve rezultoi se nga Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Pas daljes së VKM nr.48, datë 26.01.2022 për “*Transferimin, në pronësi të Bashkisë Pustec, për njësitë administrative pustec, të disa pasurive me vendndodhje në zonat kadastrale 2462 dhe 1797*” në vitin 2022, nga Bashkia Pustec janë mbajtur vazhdimisht korespondenca me ASHK për identifikimin dhe transferimin e pronave, por që ky proces nuk ka përfunduar. Identifikimi, inventarizimi dhe rregjistrimi i pronave, në pjesën dërmuese të tyre mbetet në faza fillestare, kryesisht për mungese fondesh. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit, informacionit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

**Kriteri:**

Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”,

**Ndikimi:**

Ulja e efikasitetit të bashkisë nga mos shfrytëzimi i aseteve.

**Shkaku:**

Mungesa e stafit dhe mungesë e likujditeti për përfundimin e procesit të regjistrimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së administrimit dhe menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete. Për pronat e transferuara në pronësi/përdorim Bashkisë Pustec me VKM të kryhen procedurat për evidentimin, inventarizimin, regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Korçë dhe më pas vlerësimin e tyre, si dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të pronave me qëllim rritjen e të ardhurave.

*Shpjegime për observacionin e bërë nga Bashkia Pustec me shkresën përcjellëse nr.prot 116, datë 25.01.2024 në lidhje me këtë pikë sqarojmë:*

***Pretendimi i subjektit:** Nuk jemi dakort me shprehjen e përdorur në projektraport se mungojnë kthim përgjigjet nga korrespondenca me ASHK dhe AZM, pasi ju kemi dërguar te gjithë shkresat e korrpondences ne vite.*

*-Bashkia është në proces saktësimi të pronave të saj problematike dhe që po vazhdohet të kërkohet nga institucionet qendrore. Është hapur regjistri i inventarizimit të pronave të bashkisë....*

*-Është i drejtë rekomandimi i juaj që bashkia duhet të planifikojë krijimin e strukturës së së menaxhimit të aseteve.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket këtij observacioni, sqarojmë se në asnjë rast nuk është thënë që mungon korrespondenca me ASK dhe AZM, apo regjistri i pronave, por është theksuar se duhet të vazhdohet korrpondenca për të plotësuar të dhënat për pronat për përditësimin e inventarëve të tyre në regjistrat e proanve dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor për hipotekimin e tyre në ASHK dhe vendosjen e tyre në efikasitet për rritjen e të ardhurave. Këto shpjegime janë të karakterit justifikues dhe në mungesë të argumentit ligjor. Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë.*

**2.4. Auditim mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

2.4.1.Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.4.2.Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në Bashkinë Pustec, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr.884/11, datë 18.01.2023.
- Korrespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Pustec dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve, etj.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:***

- Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

*Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:*

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.19, datë 19.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 884/11, datë 18.01.2023, verifikohet se:

-Bashkia Pustec, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe me shkresën nr.145, datë 30.01.2023, ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga Bashkia Pustec, është kthyer përgjigje me shkresën nr.962, datë 24.07.2023 për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, referuar ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Sipas plan veprimit dhe urdhrave përkatës, janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, germa j. Me shkresën nr.193 prot., datë 15.04.2021 nga Bashkia Pustec është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Nga Bashkia Pustec janë marrë masa për respektimin e afatit 6 mujor për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, referuar ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresën nr.1646 prot., datë 26.07.2023 është përcjellë relacioni për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **38** rekomandime gjithsej, nga të cilat **22** Masa Organizative, **2** masa për shpërblim dëmi, **3** masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, **10** masa administrative dhe **1** masë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **22** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **17** janë zbatuar plotësisht, **2** është

zbatuar pjesërisht ndërsa **3** janë në proces zbatimi.

-Nga **2** masa për shpërblim dëmi **2** zbatuar plotësisht.

-Nga **3** masa për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, **2** janë zbatuar dhe **1** është zbatuar pjesërisht.

-Nga **10** masa administrative, nga të cilat **10** janë zbatuar

-Nga **1** masë disiplinore, nga të cilat **1** është zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Pustec, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

- Konstatohet se: Për vitin 2022 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pustec nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Mungojnë procesverbalet lidhur me punonjësit të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.- Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**Përgjigjia e institucionit:** *Për vitin 2022 për strategjinë e risqeve, janë kryer një sërë investimesh në sistemin kompjuterik dhe po punohet për programet lehtësuese, në fushën e financës tatim taksave dhe urbanistikës. Është hartuar programi i trajnimit të punonjësve në bashkëpunim me ASPA.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

**1.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa për përmirësimin e rregullores së brendshme në drejtim të dorëzimit të detyrës nga personat e larguar, duke përcaktuar detyrimin që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjia e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, *është punuar nga sektori i burimeve njerëzore mbi përmirësimin e rregullores (kjo miratuar m vendim të Keshillit të Bashkisë Nr. 18 dt 28.02.2023 Nr302/1 Prot “Miratimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë Pustec”.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**1.3 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjia e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, *nuk është hartuar regjistri i riskut, por po punohet për vitet në vazhdim, Raportimet në shkallë hirarkie bëhen në mënyrë shkresore ose të drejtperdrejt në takimet e punës.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pustec u konstatua se për vitet 2021” Bashkia Pustec nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Pustec, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Korçë, Maliq ose Devoll.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, *Bashkia Pustec ka nënshkruar Akt marrëveshje nr.1326, datë 10.10.2023 me Bashkinë e Devollit me objekt "Për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm" për periudhën 01.01.2024-3.12.2026.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Financës, Bashkia Pustec deri më datë 31.12.2021, nuk ka likuiduar detyrime për fatura të mbërritura dhe vendime gjykate, që ju ka kaluar afati 60 ditorë për likuidim në 15 raste në vlerën gjithsej 2,339,662 lekë, detyrime që i përkasin llogarive (401-408) "Furnitor e llogari të lidhura me to", dhe (467) "Kreditorë të ndryshëm". Veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101, sipas të dhënave të Aneksit nr. 8, bashkëlidhur Raport Auditimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 2,339,662 lekë, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, janë kryer pagesat duke respektuar afatet e paraqitjes së faturave përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2021, shpenzimet buxhetore sipas akt akordimit me thesarin të planifikuara në vlerën 218,317 mijë lekë janë realizuar në vlerën 188,096 mijë lekë ose në masën 86 %, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planit dhe realizimit të shpenzimeve korrente të cilat nga 25,801 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt në vlerën 12,298 mijë lekë ose 48 %, me mosrealizim në vlerën 13,503 mijë lekë, kryesisht në mos kryerjen e shpenzimeve për disa shërbime të planifikuara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor", Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë, sipas zërave Aneksin nr. 7, bashkëlidhur Raport Auditimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga Sektori Buxhetit janë marrë masa për hartimin e një buxheti real dhe në vëmendje të objektivave.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 129,768 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi që në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën gjithsej në vlerën 17,853,280 lekë (për 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtesë, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë), në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për kontabilizimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, Sektori i financës ka kryer kontabilizimin e llog 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 17,853,280 lekë e cila është nxjerrë nga sektori i tatim taksave si detyrim pa paguar nga ana e komunitetit të bashkisë, kjo vlerë është në bilancin e vitit 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**6. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2021, konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete e analizuar për 22 projekte në vlerën 18,399,892 lekë, pavarësisht faktit që 20 prej këtyre projekteve në vlerën 2,865,892 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara. Vlera e këtyre projekteve, duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 2,865,892 lekë për vitin 2021, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 Pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë kreditimin e saj në debi të Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e kostos së tyre, në vlerën 2,865,892 lekë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, mbi shpërndarjen e llog 202 “studime dhe kërkime” për shumën 2,865,892 lekë për 22 projektet u krye shpërndarja e saj



sipas investimeve përkatëse nga sektori i financës dhe është pasqyruar në bilancin te vitit 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 45 objekte (aktive) në vlerën 50,552,353 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 25 raste, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga sektori i finances në llog 212 “Ndërtesa konstruksione”, janë shtuar shtesat për rikonstruksion dhe mirëmbajtjen e këtyre asetëve e cila u pasqyrua në mbylljen e bilancit të vitit 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 44 objekte (aktive) në vlerën 231,600,561 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 30 raste, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga sektori i financës në llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, janë pasqyruar shtesat për rikonstrukcion dhe mirëmbajtjen e këtyre aseteve e cila u pasqurua në mbylljen e bilancit të vitit 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:**Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) për vitin 2021 e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, është e analizuar për 17 objekte inventari në vlerën 8,715,343 lekë. Nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec, për objektin në vlerën 1,750,944 lekë (objekti “Furnizim, vendosje sahat uji” në vlerën 1,709,906 lekë dhe “Mbikëqyrje punimesh për vendosje sahat uji” në vlerën 41,038 lekë), me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 .Rekomandimi:** Sektori i Financës të kryej transferimin e aseteve që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël duke zbritur nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” vlerën për investimet e kryera në shumën 1,750,944 lekë.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga verifikimi rezultoi se, është në proces transferimi me shkrirjen e SHA- Bashkia Pustec dhe kalimin në shoqëri të përbashkët KORCA.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” e aktivitetit të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar të cilat janë raportuar për vlerën 6,124,305 lekë dhe nuk kuadron me këto llogari për vlerën 1,143,781 lekë, veprim në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive të Klasës së 4 të Pasivit të bilancit për diferencën në vlerën 1,143,781 lekë.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, është kryer sistemimi i llogarive të klasës 4 të pasivit për diferencën 1,143,781 lekë dhe është pasqyruar në bilancin e vitit 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga 90 objekte inventari të analizuara në kontabilitet të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llogarisë 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 283,946,750 lekë, Bashkia Pustec nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Korçë dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, është ngritur një grup pune me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 166, datë 31.10.2019 “Mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të Bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të Bashkisë Pustec”, ndryshuar me Udhërin nr. 149 prot, datë 27.09.2021 (zëvendësimi i një anëtari të larguar) ndryshuar me Urdhër Nr. 147.dt 17.08.2022(për zëvendësim të një anëtari). Ndërsa sektori i financës është ngarkuar për kontabilizimin e tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:**Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2021 ka kontratë që nuk ka përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilën është kryer pagesë, për vlerën 108,199,198 lekë, që i përket llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për kontratën me objekt “Furnizim me ujë Bashkia Pustec” me vlerë 547,692,661 lekë me afat shlyerje deri në vitin 2024. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën 108,199,198 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në

vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, është kryer evidentimi i vlerave në llogarinë 230-231.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 6,328,772 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari për vitin 2021 është kredituar për 1 objekt për vlerën 5,409,960 lekë dhe është debituar në 1 rast për vlerën 1,124,245 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 918,857 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Pustec nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. Veprime në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, është kryer procedura me thesarin.

**Komenti i grupit të auditimit:**Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**14. Gjete nga auditimi:** Në auditimin e procedurave me vlerë të vogël, nga Bashkia Pustec janë realizuar gjithsej 13 procedura me fond limit 3,071 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,574 mijë lekë me një diferencë nga fondi për vlerën 497 mijë lekë.

Në totalin e procedurave, rezulton se 5 procedura me fond limit 2,460 mijë lekë ose 84% e fondit janë zhvilluar me mjete elektronikë, ndërsa 5 procedura nuk janë zhvilluar me mjete elektronike, pasi janë nën vlerën 100 mijë lekë.

Me shkresën nr. 1316, datë 14.10.2021 është kërkuar zhvillimi i procedurës me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, miratuar me vendim nr. 73, datë 24.12.2020.

Me PV nr. 1316/9 datë 09.11.2021, KBVV ka shpallur fitues shoqërinë “S. A” shpk me ofertë 599,600 lekë, i renditur i dyti në garë, pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur për lidhje kontrate.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se ky OE nuk plotëson kriterin mbi pagesën e energjisë elektrike, pasi sipas të dhënave të dosjes dhe sistemit SPE, pasi procedura është zhvilluar me datë 05.11.2021, ndërsa subjekti ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e

energjisë nr. 323, datë 7.10.2021 në të cilën thuhet se subjekti nuk ka detyrimi, **por pa përfshirë faturën e muajt shtator 2021**. Pra vërtetimi duhet të përfshinë dhe muajt shtator. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me neni 76 pika 1 shkronja (b) dhe neni 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, Udhëzimi i APP nr. nr. 3, datë 08.01.2018 Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla dhe zhvillimi me mjete elektronike”, pika 2 dhe me Udhëzimi e MF nr.57 datë 12,06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të analizojë mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH në procedurën me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për vlerësim jo të drejtë të procedurës, si dhe të marrë masa që në të ardhmen të analizojë raportet e komisionit të vlerësimit të OE fitues që të jenë në përputhje me kuadrin ligjorë dhe në plotësim të kriterëve të DST të miratuara nga AK.

**Brenda datës 30.03.2023**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, janë kryer procedurat duke tërhequr vëmendjen personave përgjegjës si edhe janë analizuar në vazhdimësi raportet e komisioneve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**15. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi i procedurës me objekt “*Furnizimi me ujë Bashkia Pustec*”, mbi zbatimin e dispozitave në emërimin e anëtarëve të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHD) dhe Komisioni të Vlerësimit të Ofertave (KVO), rezulton se:

Nga ana e titullarit të AK Bashkia Pustec, janë hartuar dy urdhra prokurimi me të njëjtin numër protokolli (nr. 14, datë 30.12.2020), por me shkresa dhe përmbajtje të ndryshme për ngritjen e NJHDT, si vijon:

Me urdhër prokurimi me shkresën nr. 1579/1, datë 30.12.2020, ku si anëtare e NJHDT është emëruar: znj. F. S. me detyrë përgjegjëse procedurës, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020 me profil juridik, z. L. M. me detyrë Jurist bashkia Pustec dhe V. A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.

Me urdhri i prokurimi me shkresën nr. 1579/2, datë 30.12.2020 është bërë ndryshimi i anëtarëve të NJHDT, respektivisht: znj. F. S. me detyrë përgjegjëse procedurës (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020 dhe profil juridik*), znj. S. M. me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore e cila ka zëvendësuar z. L. M. **pa asnjë argument shtesë**, z. V. A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec, si dhe është shtuar zj. L. C me profesion inxhinier Gjeodet (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec*) dhe zj. H. G. me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec*).

Nga AK Bashkia Pustec nuk është argumentuar emërimi i një specialisti të jashtëm në pozicioni e përgjegjës të kësaj procedurë dhe me profil jurist, pa vetë bashkia ka në strukturë jurist me funksion përgjegjës për Sektorin e Prokurimeve, si dhe zëvendësimi i specialistit z. L. M. me zj. S. M., pa asnjë argument ligjorë për zëvendësimin e tij.

Gjithashtu, konstatohet se në sistemin e SPE të APP nga katër anëtarë që ka NJHDT sipas urdhër prokurimit, rezulton se janë tre anëtarë (F. S, L. M. dhe V. A.), si dhe nuk janë bërë ndryshimet si të anëtarit të ndryshuar po ashtu dhe të shtesa me anëtarë të riinjë.

Me urdhër nr. 1579/3, datë 30.12.2020 janë emëruar anëtarët e KVO, *respektivisht*: z. J. N. me detyrë Zv/Kryetar (jurist), z. V. S. me detyrë specialist prokurimesh (ekonomist), z. I. M. me detyrë ish- ekonomist Sektori Financës, zj. N. K. specialiste e jashtme me arsim të lartë (*shkenca politike, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020*) dhe z. E. B. specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik (*sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020*).

Nga auditimi rezulton se specialistët e jashtëm nuk janë emëruar punonjës të profilit dhe të nevojshëm për llojin e procedurës që zhvillohet, pasi njëri është më profil ing., Elektrik dhe tjetri shkenca politike, ndërkohë që duheshin minimumi ing, ndërtimi dhe hidroteknik, kjo referuar tipologjisë së procedurës së zhvilluar, rëndësisë dhe vlerës së prokuruar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 3.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, si dhe nenet 56- Titullari i AK ose zyrtari i autorizuar dhe 57- Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, në cilësinë e titullarit të AK të marrë masa që në të ardhmen në mungesë të personelit të kualifikuar të argumentojë marrjen në komision si anëtarë të NJHDT/KVO të specialistëve të jashtëm me profil sipas tipologjisë së procedurës që zhvillohet dhe jo të çfarëdolloj. Gjithashtu në rastet e largimit të anëtarëve të komisionet e NJP/KVO të argumentohet arsyeja dhe të kryhet sipas afateve ligjore pa filluar procedura e aplikimit të kriterëve ose vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

**Në vijimësi**

**Përgjigjia e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, janë marrë masa për plotësimin e komisioneve referuar natyrës së prokurimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës me objekt “Furnizimi me ujë Bashkia Pustec”, konstatohet se lidhja dhe zbatimi i kontratës është bërë pa marrë miratim nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, pasi zona e Bashkisë Pustec në të cilën do shtrihet investimi hyn në zonat e mbrojtura si PK “Prespë”, shpallur me VKM nr. 80, datë 18.2.199, kategori e II e zonave të mbrojtura, sipas IUCN-së, si dhe pa miratim të lejes së ndërtimit të lëshuar nga Sektori i Planifikim Territorit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pustec, duke u mjaftuar vetëm me lejen e zhvillimit nr. 5, datë 26.5.2021. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ligjin nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar (shtojca I dhe II), ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar dhe VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim për dhënie me koncesion të përdorimit të burimit ujorë, e lejes/autorizimit për përdorimin e burimit ujor, veprimtari ndërtimore në brigjet, veprimtari në shtratin e burimit ujorë, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura të ndotura të dokumenteve shoqërues të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit të infrastrukturës nga Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë.

Gjithashtu duke qenë se Bashkia Pustec bën pjesë në zonat e mbrojtura, përpara hapjes së ndonjë procedure prokurimi në investime të cilat prekin zonat e mbrojtura të merret paraprakisht miratimi nga instancat përkatëse për zhvillimin ose jo të zonës ku do shtrihet projekti.

#### Në vijimësi

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga Bashkia nuk ka pasur raste për investime të cilat kërkojnë leje, por në çdo rast do të plotësohet dokumentacioni sipas legjislacionit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar.

**17. Gjetje nga auditimit:** Në auditimin e procedurës me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*”, rezulton se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, konkretisht:

Në pikën 2.4 të DST janë kërkuar kategori licencash jo të argumentuara me procedurën e zhvilluar dhe zërat e preventivit, konkretisht: NP 1 – D (*punime gërmimi në tokë*); NP 4 - E; (*Rrugë autostrada, ura, mbikalime...*); NS 9-D; (*Punime strukturore speciale*); NS 18 D; (*Punime topogjeodezike*); NS - 19 D; (*sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë*) dhe N.S 20 D; (*Shpime gjeologo –inxhinierike, puse shpimi për ujë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI*).

Nuk argumentohet kërkesa ku sipas pikës 2.5 të DST është kërkuar licencës me kod III.2.B;I.2.A;III.2.A (1+2), pasi në referim të pikës (a) të nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin në mjedis”, ku qëllimi është të sigurojë nivel të lartë të ndikimit në mjedis.

Në pikën 2.8 të DST është kërkuar stafi teknik; Inxhinier Ndërtimi 2 (dy); Inxhinier Ndërtimi 1 (një) (profili transport); Inxhinier Ndërtimi 1 (një) (profili Strukturist); Inxhinier Mjedis 1 (një)..

Në pikën 1.9 të DST është kërkuar që OE duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (staf mbështetës) poshtë 1 inxhinier topograf.

Në pikën 2.12 të DST, është kërkuar ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person) në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontratën e punës dhe certifikata përkatëse. Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e procedurës kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë (gjithsej 2 OE), duke ulur konkurrencën dhe krijimin e kushteve për një përdorim jo me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, të LPP, “kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete

që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec (*grupi i punës apo komisioni përkatës*), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

#### Në vijimësi

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit janë zbatuar kërkesat e ligjit të prokurimit publik.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pustec, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm paraqitur me shkresën nr. 870/9, prot, datë 23.12.2021, rezultoi se:

Bashkia Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka** kthyer përgjigje, **brenda afatit 20 ditor**, si dhe nuk ka raportuar në KLSH **brenda 6 muajve** për masat e marra në zbatimin e rekomandimeve.

Bashkia Pustec ka hartuar “*Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve*” me shkresën nr. 90, datë 18.01.2022, në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, **por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë bashkiake**. Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar akoma 7 masa.**

**b. Për masa shpërblim dëmi, është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 300,000 lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar.**

**c. Për masa mungesë të ardhurash është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 15,039 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, ku nga vlera e rekomanduar prej 15,039 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,414 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 13,625 mijë lekë.**

**d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 7 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të Ligji nr. 154/2021, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, si dhe neni 50-Auditimi i jashtëm, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 77-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 870/9,



prot, datë 23.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pustec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

**Brenda datës 31.03.2023**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH i është kushtuar vëmendje e duhur deri në zbatimin e tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, rezulton se situacionet pjesore nuk janë shoqëruar me librezat e masave, në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa, duke ngritur grupe pune me përbërje inxhinierë të fushës, që para likuidimit të situacioneve pjesore dhe përfundimtare, të bëhet kontrolli sipas librezave të masave të paraqitur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, të cilat duhet të shoqërojnë situacionet përkatëse në çdo fazë punimesh.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, janë marrë masa për zbatimin e të gjitha kërkesave ligjore dhe vijon puna edhe në të ardhmen.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analizave të reja të çmimeve dhe të faturave të blerjes së tubave nga shoqëria “T” ShPK (e cila ka deklaruar që tubat janë brenda specifikimeve teknike), të dërguara nëpërmjet emailit nga mbikëqyrësi i punimeve, rezulton se zëri “material” në analizën e çmimeve për zërin e punës “FV tuba PE100RC me Dj 90 mm Pn16”, është marrë 2551 lekë/ml nga 519.3 lekë që është çmimi i shitjes nga shoqëria “T” ShPK, ose 2031 lekë/ml më pak se çmimi i vendosur në analizë. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune duhet të ishte 805 lekë/ml (519.3 + vlerat e elementëve të tjerë të kostos + shpenzimet plotësuese dhe fitimin), ose 2115 lekë më pak se çmimi i situacionuar (2920 – 805). Nisur nga fakti që ky tubacion është përdorur në linjat e dërgimit në sasinë 4161 ml, vlera e rritur padrejtësisht është 8,800,515 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, pika 8.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa, që për zërin e ri të punës “ FV tubacion PE100RC me Dj 110 mm Pn16”, për të cilin nuk administrohen faturat në lidhje me çmimet e blerjes, Komisioni i Marrjes në Dorëzim të objektit, në bashkëpunim me mbikëqyrësin, të hartojnë analizën korrekte të çmimit, referuar faturave të blerjes dhe analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nuk ka përfunduar pasi objekti nuk është marrë në dorëzim.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,450,180 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”**, fituar nga BOE “G.” shpk & “Sh” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likujduara, në vlerën 847,620 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3, si dhe kushtet e kontratës së sipërmarrjes së punimeve nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pustec dhe BOE “G” shpk & “Sh” shpk (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” shpk & “Sh”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” shpk & “Sh”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

### **Menjëherë**

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga Bashkia Pustec është kërkuar arkëtimi i vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” shpk & “Sh”shpk, dhe nëpërmjet bankës “C” është arkëtuar detyrimi në datën 22.11.2023 (*Bashkëlidhur dokumenti justifikues nga Thesari*)

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit të objektit “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, rezultoi se në situacionin e fundit pjesor, zëri i punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë” me vlerë të situacionuar 5,602,560 lekë, është librezuar si volum i kryer si shtresë për mbushjen e kanaleve pas shtrimit të tubacioneve, me sipërfaqe mesatare të shtresës 0.36-0.42 m<sup>2</sup>. Në fakt, nga verifikimi me zgjedhje në terren, ky zë pune, i cili sipas observacionit pretendohet të jetë kryer në shtresa rrugore, nuk është realizuar në mbushjen e kanaleve, pasi mbushja e kanalit është bërë me materialin e gërmuar.

Në dosjen teknike nuk administrohet libreza e punimeve që të vërtetojë punimin e kryer sipas faktit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë”, i cili nuk është i situacionuar sipas librezës së masave në vlerën **5,602,560 lekë** nga sipërmarrësi i punimeve, për të përcaktuar volumet sipas punimeve të kryera në fakt, duke bërë rakordimin në situacionin përfundimtar dhe në rast difference në volume, të merren masa për arkëtimin e kësaj vlere nga BOE “G” shpk & “Sh”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”.

**Menjëherë**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga verifikimi rezulton se me shkresën nr. 514 prot., datë 06.04.2023, është nxjerrë urdhri i titullarit nr. 66, datë 06.04.2023 “Për ngritjen e grupit të Punës”, për të verifikuar zërin (mbushje me zhavorr në rrugë) i përberë nga 3 specialistë. Akt vlerësimi i grupit të punës, konstaton në terren se këto punime në fakt janë kryer. Akti i vlerësimit është firmosur prej sipërmarrësit të punimeve, mbikëqyrësit të punimeve dhe komisionit të bashkisë. (Bashkëlidhur Dokumentacioni).

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pustec, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 11 subjekte debitorë në vlerën 261,452 lekë, janë aktiv 2 subjekte ose 18 % e totalit të cilët nuk paguajnë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë**.

**Brenda datës 31.03.2023**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, në bazë rekomandimeve të KLSH-së me nr. 884/11 prot., datë 18.01.2023, Sektori i Tatim Taksave për të arkëtuar detyrimet tatimore të prapambetura ka marrë masat si më poshtë:

Janë dërguar njoftim vlerësimi tatimor subjekteve për shumën e debisë prej 261,452 lekë dhe familjarëve për shumën 17,591,828 lekë, në total 17,853,280 lekë. Janë bërë urdhër bllokime të llogarive bankare për subjektet me urdhër bllokimi nr. 179 prot datë 07.02.2023. Debitorët janë pakësuar për vlerën 1,856,632 lekë për 104 subjekte dhe familje. Në mars 2023 gjendje debitorësh paraqitet për vlerën 15,996,648 lekë për 1205 subjekte dhe familje.

Është dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Korçë kërkesë për vendosjen e barrës së sigurisë për mjetet me nr. 180 prot datë 07.02.2023(*Bashkëlidhur dokumentacioni*)

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

**2. Gjetje nga auditimit:** Me urdhër nr. 22, datë 19.2.2021, Kryetari i Bashkisë Pustec ka urdhëruar përcaktimin e limitit të karburantit për mjetet e bashkisë për vitin 2021, ku sasia vjetore e parashikuar është 26396 litra/viti.

Me PV nr. 235/4, datë 01.3.2021 NJP ka bërë përlllogaritjen e fontit limit referuar çmimit të kontratave të mëparshme (nr. 349, datë 23.11.2020), me çmim 104.797 lekë/litri, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 2,766,221 lekë pa TVSh (104.797 lekë/litri \* 26396 litra).

Nga krahasimi i të dhënave me regjistrin e mjeteve sipas pasqyrave të bilancit si dhe informacionit të marrë nga specialistja e mjedisit znj. A. J, rezulton se në bashki nuk ka mjet kompaktor për transport mbetjesh në vend depozitimit sanitar në Maliq për të cilën është planifikuar një sasi vjetore karburanti prej 2500 litra/viti.

Në këto kushte kjo sasi karburanti është planifikuar padrejtësisht për vlerën 261,750 lekë/viti, veprime me mos efektivitet të fondeve publike, për të cilën bashkia nuk duhet të beje lëvrimin e tyre sipas kontratës fillestare.

Gjithashtu, vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar sasisë së karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Pustec, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, Bashkia Pustec ka planifikuar dhe miratuar normativat e karburantit sipas automejetve në përdorim si edhe i ka miratuar në këshillin bashkiak, sipas vendimeve nr. 12 dhe 13, datë 09.02.2023 “*Për miratimin e normës së harxhimit të karburantit për automjetet e bashkisë Pustec*”(Bashkëlidhur dokumentacioni).

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**3. Gjetje nga auditimit:** Në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë dhe ku fitues është shpallur bashkimi i OE “G.C” shpk & “Sh” shpk me vlerë oferte 456,410,511 lekë ose 0.025% e fondit limit, rezulton se:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, bashkimi OE “G.C” shpk & “Sh” shpk, i shpallur fitues nga KVO nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet ti propozonte titullarit të AK anulimin e procedurës, analizimin e shkaqeve dhe marrjen në analizë për ndryshimin e kushteve të procedurës (kriteret) me qëllim rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, duke rritur konkurrencën për një përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondit të prokuruar prej 456,525 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “S’kualifikimi i ofertuesve”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës ekonomike e cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondit të prokuruar.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, konstatohet se është zbatuar dhe janë marrë masat përkatëse edhe nga APP për 7 punonjës për të cilët janë ekzekutuar gjobat e vendosura në vlerën 110,000lekë/person.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

## **D. MASA DISIPLINORE.**

### **D/1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, *titullari i Bashkisë Pustec ka nxjerrë vendimin nr.2, datë 21.07.2023 administruar me nr.927 prot., dhe ka vendosur marrjen e masave disiplinore për 1 punonjës Donka Sotiri “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

## **E. MASA ADMINISTRATIVE.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 2.4 faqe 50-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec që në zbatim të nenit 132, të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative ose disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për 10 (dhjetë) punonjësve/ dhe ish- punonjësve, si më poshtë:

1. Zj. F. S, në cilësinë e Përgjegjësit të Procedurës, specialiste e jashtëm sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020, me profil Jurist.
2. Z. V. A, me detyrë me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.
3. Zj. S. M, me detyrë Specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore.
4. Zj. L. C., me profesion inxhinier Gjeodet, specialiste e jashtëm sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec.
5. Zj. H. G., me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave, specialiste e jashtëm sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në aplikimin e kritereve jo të mirë argumentuara në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, në shkelje të nenit 77, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe jo në përshatje me objektin e procedurës së prokurimit, duke çuar në mospjesëmarrjen e OE apo në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme.

6. Z. J. N, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Pustec.
7. Z. V. S, me detyrë Specialist në Sektorin e Procedurave.
8. Zj. N. K, specialiste e jashtëm me arsim të lartë “shkenca politike”, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
9. Zj. E. B, specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
10. Z. I. M me detyrë ish- specialist Sektori i Financës.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, ku bashkimi i OE “G.C” shpk & “Sh” shpk, i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kritereve të miratuara në DST nga AK NSHP Bashkia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, *Kryetari i Bashkisë Pustec i është drejtuar APP-së me shkresën nr.249 prot., datë 20.02.2023 lidhur me vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga KLSH dhe marrjen e masave përkatëse për personat përgjegjës.*

*APP me vendimin nr.46, datë 29.06.2023 dërguar Bashkisë Pustec me shkresën nr.2476/6, datë 29.06.2023, për dijeni KLSH ka vendosur marrjen e masave administrative me gjobë për personat përgjegjës sipas rekomandimit të KLSH, si dhe i ka propozuar Bashkisë Pustec*

marrjen e masave disiplinore për dy punonjës në cilësinë e anëtarëve të KVO për prokurimet me vlerë të vogël.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

#### **F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**Përgjigjja e institucionit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nuk janë kryer njoftimet në DAP.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

| Emërtimi            | Rekomanduar | Zbatuar   | Pa zbatuar | Në proces | Pjesërisht |
|---------------------|-------------|-----------|------------|-----------|------------|
| Masa Organizative   | 22          | 17        | -          | 3         | 2          |
| Masa Shpërblim dëmi | 2           | 2         |            |           |            |
| Efekte negative     | 3           | 2         |            |           | 1          |
| Administrative      | 10          | 10        |            |           |            |
| Disiplinore         | 1           | 1         |            |           |            |
| <b>Total</b>        | <b>38</b>   | <b>32</b> |            | <b>3</b>  | <b>3</b>   |

#### ***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

-Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.

- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 84 %.

*(Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr.1, datë 29.12.2023)*

|   |
|---|
| <b>Titulli gjetjes:</b> Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve |
|---|

#### **Situata:**

-Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditivin financiar dhe përputhshmërisë” për vitin 2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.19, datë 19.01.2023, të

Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 884/11, datë 18.01.2023, verifikohet se:

Sipas plan veprimit dhe urdhrave përkatës, janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **38** rekomandime gjithsej, nga të cilat **22** Masa Organizative, **2** masa për shpërblim dëmi, **3** masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, **10** masa administrative dhe **1** masë disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **22** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **17** janë zbatuar plotësisht, **2** janë zbatuar pjesërisht ndërsa **3** janë në proces zbatimi.

-Nga **2** masa për shpërblim dëmi **2** zbatuar plotësisht.

-Nga **3** masa për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduara, **2** janë zbatuar dhe **1** është zbatuar pjesërisht.

-Nga **10** masa administrative, nga të cilat **10** janë zbatuar

-Nga **1** masë disiplinore, nga të cilat **1** është zbatuar

-Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 84 %.

**Kriteri:**

ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

**Impakti:**

Përmirësimi i menaxhimit të institucionit.

**Shkaku:**

Afatet kohore për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

**Rëndësia:** *E ulët*

**Për këtë rekomandimë:**

Kryetari i Bashkisë Pustec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të rekomandimeve, që janë në proces zbatimi dhe rikërkojmë të marrin masa për zbatimin e rekomandimeve, që rezultojnë të zbatuara pjesërisht, si vijon:

- **Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendorsjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

- **Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik,



për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

- **Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë**.

## 2.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Gjatë auditimit nuk pati probleme apo çështje të tjera për të shqyrtuar.

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASAT ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së, rezultojnë strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec nuk kanë zbatuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, e konkretisht:

- Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre.

- Bashkia Pustec nuk disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

- Bashkia Pustec e kryen aktivitetin e saj në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar me VKB nr.18, datë 28.02.2023 *“Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Pustec”*, ndërsa për vitin 2022, Bashkia Pustec nuk ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje.

- Bashkia Pustec disponon disa përshkrime pune, por procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me legjislacionin. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP. Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve.

- Bashkia Pustec nuk ka hartuar një strategji risku dhe nuk disponon procedurë të menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve, si dhe mungojnë raporte monitorimi të fushave me risk.

- Titullari i Bashkisë Pustec për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.

- Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës.

- Bashkia Pustec nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre.

- Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pustec nuk ka hartuar planin vjetor të trajnimeve për punonjësit.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Bashkia Pustec nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim ligjin nr.

10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin e MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat e udhëzimet e dala në zbatim tij (*Më hollësisht trajtuar në faqet 17-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i institucionit me atributet e Kryetarit të GMS, të marrë masa të menjëhershme, që të njohë punonjësit me aktet ligjore e nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

- Të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.

- Të ndjekë me rigoroze aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Pustec, konstatohet se për vitin 2022 nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm. Për realizimin e shërbimit të brendshëm të auditimit me shkresën nr.1326, datë 10.10.2023, nga Bashkia Pustec përfaqësuar nga z.P. K. dhe z.E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Bilisht, është nënshkruar Akt Marrëveshja për kryerjen e këtij shërbimi për periudhën 01.01.2024-31.12.2026. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 49 dhe me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për kryerjen e auditimit nga struktura e auditit të Bashkisë Bilisht për veprimtarinë ekonomiko-financiare, referuar Marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Bilisht.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se:

**a.** Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 150,202 mijë lekë nga 190,699 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 79%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i artikullit 602 “Shpenzime operative” në masën 53%, i artikullit të pagave dhe sigurimeve në masën 80% si dhe i artikullit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 83%, artikuj buxhetorë të planifikuar përtej burimeve të financimit.

**b.** Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga viti paraardhës. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 147,866,325 lekë, që përbëhet nga vlera prej 146,020,720 lekë e projektit të ndërtimit të ujësjellësit, që financohet nga AKUM në 2-3 vite dhe vlera prej 1,801,335 lekë i përket stokut të detyrimeve për fatura të palikujduara me burim financimi të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar. Stoku i detyrimeve të papaguara që i takon Bashkisë është në masën 1.05 % të shpenzimeve të planifikuara. Detyrimet e papaguara të raportuara në MFE nuk rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, për vlerën 1,685,037 lekë.

**c.** Financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 96.65% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar e transfertat specifike) dhe 3.35% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera.

d. Për vitin 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore, por vetëm raport vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit në nivel programesh.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 52,65; ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42,48; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë reale dhe të argumentuar, si dhe të parashikohet mbulimi me fonde i detyrimeve të prapambetura. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Të përgatiten dhe të paraqiten pranë Këshillit Bashkiak raportet e monitorimit periodik të realizimit të buxhetit, për matjen e performancës financiare, realizimin e produkteve dhe objektivave për çdo program të përcaktuar në vitin ushtrimor.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*” në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit që përbëhet nga shuma e: llog.401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në vlerën 1,721,533 lekë, llog.42 “*Detyrime ndaj personelit*” për vlerën 3,328,068 lekë, llog.431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” për vlerën 136,195 lekë, llog.435 “*Sigurime shoqërore*” për vlerën 1,007,446 lekë, llog.436 “*Sigurime shëndetësore*” për vlerën 133,546 lekë dhe llog. “*Furnitorë të ndryshëm dhe llogari të lidhura me to*” në vlerën 146,181,288 lekë, të cilat janë shumën 152,508,076 lekë. Ky kontabilizim i gabuar ka sjellë pasaktësi në gjendjen e llogarisë analoge 7206, “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në pasqyrën e performancës Formati 2 i PF. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3, nënpika 8 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Pustec në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara të shtetit/bashkia ndaj të tretëve në llogarinë 4342, “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, duke përfshirë detyrimet të gjitha detyrimet për paga, sigurime, tatime ndaj punonjësve dhe detyrimet e lindura ndaj të tretëve për fatura të papaguara në fund të vitit ushtrimor.

#### *Deri me datë 31.03.2024*

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 231 “*Shpenzime për investime në proces*” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që ka investime në proces. Në fund

të vitit 2022 konstatohet se 2 kontrata investimesh në vlerë të plotë 570,599,453 kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 410,820,675 lekë dhe vlera pjesore e paguar prej 159,504,255 lekë duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 “Shpenzime për investime në proces” me datë 31.12.2022 dhe jo gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, duke i kaluar pagesat në mënyrë të gabuar në llogarinë e aktivit, pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të jetë i kujdesshëm në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në pagesën në vlerë të plotë. Pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

*Deri me datë 31.03.2024*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur aktiv për aktiv, për llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”, llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe llog.215 “Mjete transporti” në masën 5%, për llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në masën 20% duke respektuar normat ligjore të miratuara. Ndërsa në rastin e përlllogaritjes së aktiveve të llog. 218 “Inventar Ekonomik” është përlllogaritur gabim norma e amortizimit në masën 10% dhe jo 20% sa është norma e amortizimit e miratuar dhe për artikullin “kompjuter” në masën 25% sic i takon këtij grupaktivesh. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 36 (Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Pustec të llogarisë në mënyrë të saktë amortizimin e aktiveve të llog.218 “Inventar ekonomik” sipas normave ligjore dhe të kryejë veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse. Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023 të ketë në konsideratë veprimet rregullta në llogaritjen e amortizimit vjetor si dhe të reflektojë ndryshimet si rrjedhojë e korrigjimeve të kryera për efekt të mbylljes së vitit ushtrimor 2022.

*Deri me datë 31.03.2024*

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” përfaqëson detyrimin që, të tretët i kanë shtetit/bashkisë për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme dhe viti ushtrimor. Në këtë rast gjendja e kësaj llogarie është e pasaktë, pasi detyrimet e debitorëve ndaj shtetit në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë, që i korrespondon gjendjes së llogarisë antiparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 3.3 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit/bashkisë si debitorët, duke i evidentuar në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri me datë 31.03.2024*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi dhe shqyrtimi i veprimtarisë dhe të dhënat në lidhje me procedurat e inventarizimit dhe regjistrimit të asetëve rezultoi se nga Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Asetëve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Pas daljes së VKM nr.48, datë 26.01.2022 për “*Transferimin, në pronësi të Bashkisë Pustec, për NJA Pustec, të disa pasurive me vend-ndodhje në zonat kadastrale 2462 dhe 1797*” në vitin 2022, nga Bashkia Pustec janë mbajtur vazhdimisht korrespondenca me ASHK për identifikimin dhe transferimin e pronave, por ky proces nuk ka përfunduar. Identifikimi, inventarizimi dhe regjistrimi i pronave, në pjesën dërmuese të tyre mbetet në faza fillestare, kryesisht për mungesë fondesh. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit, informacionit nga ASHK, Drejtoria Korçë dhe të përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë. Kjo situatë e administrimit të pronave si dhe klasifikimi me VKM e të gjithë territorit të Bashkisë Pustec në zonë e mbrojtur ka sjellë, që kjo njësi vendore të mos mund të realizojë të ardhura nga vënia në funksion e këtyre asetëve. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 26 dhe 27, me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, , si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së administrimit dhe menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete. Për pronat e transferuara në pronësi/përdorim Bashkisë Pustec me VKM të kryhen procedurat për evidentimin, inventarizimin, regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Korçë dhe në fund vlerësimin e tyre, si dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të pronave me qëllim rritjen e të ardhurave.

*Menjëherë dhe në vijimsi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.19, datë 19.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 884/11, datë 18.01.2023, verifikohet se:

Sipas plan veprimit dhe urdhrave përkatës, janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **38** rekomandime gjithsej, nga të cilat **22** Masa Organizative, **2** masa për shpërbllim dëmi, **3** masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit, **10** masa administrative dhe **1** masë disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **22** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **17** janë zbatuar plotësisht, **2** janë zbatuar pjesërisht, ndërsa **3** janë në proces zbatimi.

-Nga **2** masa për shpërbllim dëmi **2** zbatuar plotësisht.

-Nga **3** masa për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, **2** janë zbatuar dhe **1** është zbatuar pjesërisht.

-Nga **10** masa administrative, nga të cilat **10** janë zbatuar.

-Nga **1** masë disiplinore, nga të cilat **1** është zbatuar.

-Drejtorja Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve. Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 84 %. (*Më hollësisht trajtuar në faqet 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të rekomandimeve, që janë në proces zbatimi dhe rikërkojmë të marren masa për zbatimin e rekomandimeve, që rezultojnë të zbatuara pjesërisht, si vijon:

- **Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe ndikimi/efektiviteti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

- **Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (hartat) e proceseve të punës.

- **Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 17,853,280 lekë.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se në fund të vitit 2021 janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën 17,953,280 lekë, nga të cilët 11 subjekte të biznesit dhe 1336 taksapagues familjarë. Gjatë vitit 2022 është krijuar një vlerë debitorësh shtesë prej 1,577,700 lekë dhe në fund të vitit 2022 janë debitorë për detyrime tatimore në vlerën progresive prej 19,710,980 lekë, 11 subjekte të biznesit në vlerën 357,192 lekë dhe 1292 abonentë familjarë në vlerën 19,353,788 lekë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët nuk ka proceduar me masa shtrënguese për arkëtimin e taksave e tarifave vendore. Gjithashtu debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 në vlerën 1,577,700 lekë nuk janë evidentuar në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104 dhe nr. 43, datë 23.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 19,653,980 lekë. Gjithashtu të marrë masa për raportimin në Sektorin e Financës të debitorëve, të shtesave apo pakësimeve vitit ushtrimor dhe të vitit paraardhës, me qëllim evidentimin dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023.

*Deri me datë 31.03.2024*

## **D. MASA DISIPLINORE.**

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

*a - “Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 12 punonjës si më poshtë:*

1. z. Q. Th. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,
2. zj.E. A. me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për mangësitë e konstatuara:

Në mospërputhje me kërkesat e VKB nr. 43, datë 23.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 neni 24, neni 4 pika 7, nenet 89, 90, 91,93,94, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut XI nenet 88 deri 104 për:

- Mos marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore nga biznesi i madh, i vogël dhe familjarë, të cilat në fund të vitit 2022 janë në vlerën progresive debitoare prej 19,710,980 lekë për taksa e tarifa vendore.

- Planifikim jo i saktë i taksave për familjarët, pasi për një pjesë e taksapaguesve familjarë mungojnë të dhënat personale të përditësuara për arsye lëvizjesh demografike. Mos ndjekje e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve, nga 1291 familje debitoare për vlerën 13,481,985 lekë për ndërtese e trualli e tarifat pastrim-gjelbërimit si dhe nga 1167 fermerë debitorë në vlerën 5,871,803 lekë për taksën e tokës.

3. z. C. N. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

Për mangësitë e konstatuara:

Në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ,si:

- Gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*” në aktiv të bilancit në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,047,686 lekë, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit.

- Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime për investime në proces” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2022 konstatohet se 2 kontrata investimesh të pa mbyllura, ku vlera pjesore e paguar prej 159,504,255 lekë duhet ti përkiste gjendjes debitoare llog. 231 “Shpenzime për investime në proces” dhe jo gjendjes së llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë.

- Përlllogaritja e amortizimit të aktiveve të llog. 218 “*Inventar Ekonomik*” është bërë gabim mbi bazën e normës së amortizimit prej 10% dhe jo 20% sa është norma e amortizimit e miratuar dhe për artikullin “kompjuter” jo në masën 25% siç i takon këtij grupaktivesh.

- Gjendja e llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,868 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Në këtë rast gjendja e kësaj llogarie është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 17,983,048 lekë, që i korrespondon gjendjes së llogarisë antiparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**